

20120982542

L I G J **PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR**

Kreu I

Parime themelore

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor, përfshirja e të siguruarve, të drejtat që realizohen nga ky sigurim, evidenca amë e të siguruarve dhe shfrytëzuesve të të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, bazat e sigurimit pensional me financim kapital, si dhe kushtet e veçanta në të cilat kategori të veçanta të të siguruarve i realizojnë të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Neni 2

(1) Sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor përbëhet nga:

- sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës (në tekstin e mëtutjeshëm: shtylla e parë),
- sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital (në tekstin e mëtutjeshëm: shtylla e dytë) dhe
- sigurimi vullnetar pensional me financim kapital (në tekstin e mëtutjeshëm: shtylla e tretë).

(2) Sigurimi pensional i detyrueshëm dhe vullnetar me financim kapital më afërsisht janë rregulluar me ligje të veçanta.

Neni 3

Me shtyllën e parë pensionale, e mbi parimin e drejtësisë sociale dhe solidaritetit të gjeneratës, realizohen të drejta në rast të pleqërisë, invaliditetit, vdekjes dhe dëmtimit trupor, e me shtyllën e dytë pensionale realizohen të drejta në pajtim me ligjin që e rregullon sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 4

Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor fitohen dhe realizohen varësisht nga mënyra, kohëzgjatja dhe vëllimi i depozitimit të mjeteve për sigurim pensional dhe invalidor në kushte të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 5

Të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor janë:

- 1) e drejta e pensionit sipas pleqërisë;
- 2) e drejta e pensionit invalidor;
- 3) e drejta e rehabilitimit profesional dhe të drejta të kompensimeve adekuate me para;
- 4) e drejta e pensionit familjar;
- 5) e drejta e kompensimit me para për dëmtim trupor dhe
- 6) e drejta e shumës më të ulët të pensionit.

Neni 6

(1) Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor janë të drejta të patjetërsueshme personale materiale dhe nuk mund t'u barten personave tjerë.

(2) Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor nuk mund të parashkruhen, përveç shumave të arritura, ndërsa të papaguara të pensioneve dhe të pranimeve tjera me para, në rastet e përcaktuara me ligj.

(3) Shfrytëzimi i të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor të realizuara sipas këtij ligji mund të ndërpritet ose të kufizohet vetëm në rastet dhe në kushtet e parapara me këtë ligj.

Neni 7

(1) Mjetet e nevojshme për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor i sigurojnë të siguruarit dhe punëdhënësit nëpërmjet pagimit të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor në pajtim me ligjin.

(2) Mjetet për sigurim pensional dhe invalidor në rastet dhe në kushtet e përcaktuara me këtë ligj, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 8

(1) Mjetet për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor sigurohen, përkatësisht realizohen në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Fondi).

(2) Fondi ka cilësi të personit juridik.

(3) Selia e Fondit është në Shkup.

(4) Veprimtaria e Fondit është me interes publik.

Neni 9

(1) Kategori të caktuara të të siguruarve, me përjashtim, në raste të përcaktuara me dispozitat e këtij ligji, mund të fitojnë dhe realizojnë të drejtë për pension në kushte të posaçme.

(2) Kategoritë e caktuara të të siguruarve, kriteret më të afërta për realizimin e të drejtave sipas paragrafit (1) të këtij neni, si dhe sigurimi i mjeteve për ato të drejta rregullohen me këtë ligj.

Neni 10

Për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor sigurohet procedurë dyshkallëshe dhe mbrojtje gjyqësore e të drejtave.

Kreu II

Të siguruarit

Neni 11

(1) Të siguruar me sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor janë:

1) punëtorët në marrëdhënie pune dhe persona të barazuar me ta, në pajtim me ligje të posaçme;

2) personeli ushtarak dhe civil në pajtim me ligjin;

3) bartësit e zgjedhur ose të emëruar të funksionit publik ose funksionit tjetër, nëse për kryerjen e funksionit marrin rrogë, përkatësisht realizojnë kompensim të rrogës për kryerjen e atij funksioni;

4) shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët në territorin e Republikës së Maqedonisë janë punësuar në organe të huaja dhe ndërkombëtare, organizata dhe institucione, te përfaqësitë e huaja diplomatike dhe konsullore ose janë në shërbim personal të shtetasve të huaj, nëse me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe;

5) shtetasit e Republikës së Maqedonisë të punësuar në vend të huaj, nëse gjatë asaj kohe nuk janë siguruar në mënyrë të detyrueshme te bartësi i huaj i sigurimit;

6) shtetasit e Republikës së Maqedonisë të punësuar te punëdhënësi i huaj në shtetin në të cilin janë siguruar në mënyrë të detyrueshme, por në të cilin të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor, që si të drejta janë përcaktuar me këtë ligj, nuk mund t'i realizojnë ose nuk mund t'i shfrytëzojnë jashtë atij shteti;

7) personat e vetëpunësuar – persona fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur ekonomike ose shërbim profesional dhe shërbim tjetër intelektual nga i cili realizojnë të ardhura, në pajtim me ligjin;

8) personat fizikë që kryejnë veprimtari, e nuk kanë bazë tatimore;

9) bujqit individualë – detyrës tatimorë nga të ardhurat e veprimtarisë bujqësore që veprimtarinë bujqësore e kanë profesion të vetëm (bujqit individualë);

10) personat e papunësuar që marrin kompensim me para më së shumti deri në mbarimin e 15 viteve të stazhit pensional;

11) invalidët e punës gjatë kohës së pritjes për dërgim dhe gjatë kohës së rehabilitimit profesional dhe punësimit adekuat;

12) artistët e pavarur të cilët statusin e tillë kanë fituar sipas kriterëve, në procedurë adekuate dhe akt adekuat të ministrit të Kulturës dhe

13) sportistët profesionalë që kanë lidhur marrëveshje për punësim me klubin sportiv profesional.

(2) Fondi më afërsisht e rregullon mënyrën e përcaktimit të cilësisë së të siguruarit për personat nga paragrafi (1) pikat 4, 5, 6, 8, 9 dhe 12 të këtij neni.

Neni 12

(1) I siguruari mund të përfshihet në sigurimin e vazhduar për kohën e kaluar:

1) në përsosje ose arsim profesional në vend ose jashtë vendit me pëlqim të punëdhënësit;

2) në qëndrim në vend të huaj si bashkëshort/e i/e punëtorit që është dërguar në punë në vend të huaj në suazat e bashkëpunimit ndërkombëtar teknik ose arsimor kulturor dhe bashkëpunimit shkencor në përfaqësi diplomatike dhe konsullore;

3) pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës të bashkëshortit/es të personit ushtarak aktiv të zhvendosur për nevojë të shërbimit, më së shumti deri në katër vjet;

4) pas ndërprerjes së të drejtës së kompensimit me para në rast të papunësisë, më së shumti deri në tre vjet dhe

5) gjatë kohës së mungesës së papaguar, më së shumti deri në tre muaj.

(2) Për marrje të sigurimit të vazhduar, i siguruari, përkatësisht personi parashtron kërkesë të njëjësia rajonale e Shërbimit Profesional të Fondit në afat prej gjashtë muajsh nga ndërprerja e sigurimit të detyrueshëm, ndërsa i siguruari nga paragrafi (1) pika 4 të këtij neni, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Me kërkesën nga paragrafi (2) i këtij neni i siguruari dorëzon dëshmi për përcaktimin e rrethanave në bazë të të cilave garantohet sigurimi i vazhduar.

Neni 13

(1) Detyrimisht sigurohen edhe punëtorët nga neni 11 paragrafi (1) pikat 1 dhe 3 të këtij ligji që janë dërguar në punë në vend të huaj dhe gjatë kohës së punës në vend të huaj, nëse nuk janë të siguruar në mënyrë të detyrueshme sipas rregullave të shtetit në të cilin janë dërguar ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Detyrimisht sigurohen edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë që kanë themeluar marrëdhënie pune te punëdhënësi i cili kryen veprimtari në vend të huaj.

Neni 14

Detyrimisht sigurohen edhe shtetasit e huaj edhe personat pa shtetësi të cilët në territorin e Republikës së Maqedonisë janë:

1) të punësuar te punëdhënësi;

2) persona të vetëpunësuar;

3) në shërbim të personave të huaj fizikë dhe juridikë, nëse me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe dhe

4) në shërbim të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, të përfaqësive të huaja diplomatike dhe konsullore, nëse sigurimi i tillë është paraparë me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.

Neni 15

(1) Me sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit trupor të shkaktuara me lëndim në punë ose sëmundje profesionale të siguruar janë:

1) nxënësit dhe studentët kur kryejnë punë praktike gjatë kohës së shkollimit, përkatësisht studimit;

2) personat në vuajtje të dënimit me burg, burgut të të miturve dhe në vuajtje të masës edukative në shtëpi edukative – përmirësuese gjatë kohës së punës së rregullt që e kryejnë gjatë vuajtjes së dënimit, përkatësisht masës;

3) punëtorët shëndetësorë me arsim të lartë të cilët fitojnë përvojë pune për dhënien e provimit profesional dhe

4) personat e papunësuar gjatë kohës së aftësisimit profesional dhe rehabilitimit profesional.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni kanë të bëjnë edhe me shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët në pajtim me rregullat në fuqi dërgohen për shkollim në vend të huaj.

(3) Dispozitat nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni kanë të bëjnë edhe me shtetas të huaj që gjenden për shkollim në Republikën e Maqedonisë nëse shteti, shtetas të të cilit janë ata, poashtu vepron me shtetasit e Republikës së Maqedonisë nëse me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 16

Me sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit trupor të shkaktuara me lëndim, sigurohen edhe personat të të cilët lëndimi ka ndodhur me pjesëmarrje:

1) në aksione për shpëtim ose mbrojtje nga katastrofat ose fatkeqësitë elementare;

2) në angazhim në punë të shfrytëzuesve të ndihmës sociale;

3) në trajnim me ftesë të organeve të mbrojtjes;

4) në dhënien e ndihmës organeve për punë të brendshme në kryerjen e detyrës së tyre zyrtare;

5) në manifestime kulturore artistike dhe gara, të organizuara nga institucionet kulturore dhe institucionet tjera;

6) në gara në kulturë fizike dhe teknike, të organizuara nga institucionet sportive dhe institucionet tjera;

7) në aktivitet vullnetar në pajtim me ligjin;

8) të sportistit amator në pajtim me ligjin dhe

9) të sportistit profesional që ka lidhur marrëveshje profesionale me klubin sportiv profesional.

Neni 17

Fondi më afërsisht e përcakton mënyrën e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor të personave nga nenet 15 dhe 16 të këtij ligji.

Kreu III

Marrja dhe përcaktimi i të drejtave

Pensioni i pleqërisë

Neni 18

I siguruari fiton të drejtë për pension të pleqërisë kur do t'i mbushë 64 vjet (mashkull), përkatësisht 62 vjet (femër) dhe së paku 15 vjet stazh pensional.

Zvogëlimi i kufirit të moshës

Neni 19

(1) Të siguruarit të cilit stazhi i sigurimit i llogaritet me kohëzgjatje të shtuar, kufiri i moshës për marrjen e të drejtës së pensionit të pleqërisë zvogëlohet varësisht nga shkalla e rritjes së stazhit, edhe atë për nga një vit:

1) për çdo shtatë vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 13 muaj;

2) për çdo gjashtë vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 14 muaj;

3) për çdo pesë vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 15 muaj;

4) për çdo katër vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 16 muaj;

5) për çdo tre vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 17 muaj dhe

6) për çdo tre vjet të kaluara në vende të punës në të cilat 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 18 muaj;

(2) Të siguruarit të cilit 12 muaj stazh të kaluar në mënyrë efektive në sigurim llogaritet si stazh i sigurimit me kohëzgjatje të rritur në vende të punës dhe punë të cilat kryhen nën tokë dhe i cili gjatë sigurimit ka qenë i caktuar në punë dhe vende të punës me shkallë të ndryshme të rritjes së stazhit të sigurimit, kufiri i moshës për marrjen e të drejtës për pension të pleqërisë zvogëlohet për secilën periudhë të kaluar në vendin e punës me shkallë të caktuar të rritjes së stazhit, proporcionalisht me kohën e kaluar në atë vend pune me zvogëlimin e kufirit të moshës nga paragrafi (1) i këtij neni. Zvogëlimi i përgjithshëm i kufirit të moshës përcaktohet si shumë e zvogëlimeve të përcaktuara proporcionalisht për secilën periudhë individuale.

Baza e pensionit

Neni 20

(1) Pensioni sipas pleqërisë përcaktohet nga mesatarja mujore e rrogave që i siguruari i ka realizuar gjatë kohëzgjatjes së përgjithshme të sigurimit, e më herët nga 1 janari 1970 (në tekstin e mëtejshëm: baza e pensionit).

(2) Për caktimin e bazës së pensionit, krahas mesatares mujore të rrogave merret edhe kompensimi i rrogave, përkatësisht kompensimi me para në rast të papunësisë.

(3) Si vit i sigurimit nga i cili merret rroga për përcaktimin e bazës së pensionit merret viti kalendarik në të cilin i siguruari ka realizuar rrogë, përkatësisht kompensim me para së paku për gjashtë muaj stazh të sigurimit.

(4) Rroga, përkatësisht kompensimi i rrogës së realizuar në vitin në të cilin i siguruari e realizon të drejtën për pension të pleqërisë nuk merret për përcaktimin e bazës së pensionit.

Neni 21

(1) Të siguruarit, përkatësisht personit i cili nuk ka realizuar rrogë, përkatësisht kompensim të rrogës pas janarit 1970, baza e pensionit i përcaktohet varësisht nga ndryshimi i rrogës mesatare të të gjithë të punësuarve në Republikë dhe përgatitja profesionale e të siguruarit.

(2) Bazën nga paragrafi (1) i këtij neni në fillim të vitit e shpall Fondi.

Neni 22

Për përcaktimin e bazës së pensionit merren rrogat, kompensimet me para, përkatësisht bazat e sigurimit që i siguruari i ka realizuar në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

Neni 23

(1) Për përcaktimin e bazës së pensionit merret rroga mesatare mujore që i siguruari e ka realizuar me orar të plotë të punës.

(2) Rroga që është realizuar me punë më të gjatë ose më të shkurtër se orari i plotë i punës, llogaritet në shumën mesatare mujore që korrespondon me rrogën për orarin e plotë të punës.

(3) Të siguruarit i cili në vitin kalendarik ka qenë njëkohësisht në marrëdhënie pune me orar të punës më të shkurtër se orari i plotë i punës te më shumë punëdhënës, rroga i llogaritet ashtu që merren rroga e përgjithshme e realizuar dhe orët e kaluara në punë në marrëdhënie pune te të gjithë punëdhënësit me orar të plotë të punës.

(4) Rroga e realizuar me punë më të gjatë se orari i plotë i punës, merret për përcaktimin e bazës së pensionit vetëm nëse puna e tillë është kryer në rastet e parapara me dispozitat e rregullave të përgjithshme nga marrëdhëniet e punës.

(5) Gjatë kohës për të cilën i siguruari ka realizuar kompensim të rrogës për orar të shkurtuar të punës për shkak të kurimit të fëmijës me hendikep më të rëndë, për përcaktimin e bazës së pensionit merret kompensimi me para sipas rregullave që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale.

Neni 24

(1) Gjatë përcaktimit të bazës së pensionit, rroga e përgjithshme e realizuar me punë me orar të plotë, më të shkurtër se orari i plotë dhe më të gjatë se orari i plotë i punës në një vit, reduktohet me shumë mesatare mujore e cila korrespondon me rrogën për orar të plotë të punës.

(2) Shuma që korrespondon me rrogën për orarin e plotë të punës sipas paragrafit (1) të këtij neni, llogaritet ashtu që shuma e përgjithshme e rrogave që merret parasysht për përcaktimin e bazës së pensionit, e të cilat i siguruari i ka pranuar për një vit, pjesëtohet me numrin e orëve që ai i ka kaluar në punë me orar të plotë, më të shkurtër se orari i plotë dhe më të gjatë se orari i plotë i punës, ndërsa shuma e fituar në këtë mënyrë për orë shumëzohet me mesataren mujore të numrit të orëve të orarit të plotë të punës te punëdhënësi në periudhën në të cilën është realizuar rroga. Shuma e fituar e rrogës në këtë mënyrë merret për përcaktimin e bazës së pensionit.

Neni 25

(1) Gjatë kohës së pengimit të përkohshëm nga puna për shkak të sëmundjes dhe lëndimit, përkatësisht gjatë kohës së mungesës nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë, për përcaktimin e bazës së pensionit merret kompensimi i rrogës.

(2) Kompensimi i rrogës nga paragrafi (1) i këtij neni valorizohet me koeficientin me të cilin valorizohen rrogat për atë vit.

Neni 26

(1) Për përcaktimin e bazës së pensionit të personave të papunësuar që marrin kompensim me para në rast të papunësisë, invalidëve të punës në rast të rehabilitimit profesional, merret kompensimi me para.

(2) Kompensimi me para valorizohet me koeficientin me të cilin valorizohen rrogat për atë vit.

Neni 27

Për përcaktimin e bazës së pensionit të të punësuarve invalidë të punës që marrin kompensim me para për punën me orar të shkurtuar të punës ose kompensim me para për shkak të rrogës më të vogël, krahas rrogës së realizuar merret edhe kompensim me para i llogaritur me koeficientin e valorizimit nga viti në të cilin është realizuar ai kompensim.

Neni 28

Për përcaktimin e bazës së pensionit për të siguruarit nga neni 11 paragrafi (1) pika 3 të këtij ligji merret rroga, përkatësisht kompensimi për kryerjen e atij funksioni që ka shërbyer si bazë për pagimin e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 29

Për përcaktimin e bazës së pensionit për të siguruarit nga neni 13 i këtij ligji, merret rroga, përkatësisht baza e sigurimit që ka shërbyer si bazë për pagimin e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 30

Për përcaktimin e bazës së pensionit për të siguruarit nga neni 11 paragrafi (1) pikat 4, 5 dhe 6 dhe neni 14 të këtij ligji, merret baza e sigurimit e cila ka shërbyer si bazë për pagimin e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 31

(1) Baza e pensionit të punëtorëve në marrëdhënie pune përcaktohet nga rrogat e realizuara në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

(2) Baza e pensionit të bujqve individualë përcaktohet nga bazat e sigurimit.

(3) Të siguruarve nga neni 11 paragrafi (1) pikat 8 dhe 12 të këtij ligji, baza e pensionit u përcaktohet nga bazat nga të cilat është llogaritur dhe paguar kontribut për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 32

(1) Për përcaktimin e bazës së pensionit merret edhe kompensimi i realizuar në bazë të inovacionit, racionalizimit dhe llojeve tjera krijuese në punë, në pajtim me ligjin dhe marrëveshje kolektive, nëse është paguar kontributi për sigurim pensional dhe invalidor.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni gjatë përcaktimit të bazës së pensionit merret sikur të jetë realizuar në vitin në të cilin është paguar.

Neni 33

(1) Rrogat nga vitet e mëparshme që merren për përcaktimin e bazës së pensionit, valorizohen me koeficientet e llogaritura në bazë të ndryshimit të rrogave të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë.

(2) Valorizimi i rrogave nga vitet e mëparshme sipas të cilave përcaktohet pensioni, kryhet sipas mesatares së rrogave në vitin e fundit kalendarik që i paraprin vitit në të cilin i siguruari e realizon të drejtën për pension.

(3) Koeficientet për valorizimin e rrogave nga vitet e mëparshme përcaktohen çdo vit, vetëm për të gjitha rrogat në bazë të të dhënave statistikore për ndryshimin e rrogave të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë.

(4) Koeficientet për valorizim i shpall Fondi.

Lartësia e pensionit të pleqërisë

Neni 34

(1) Pensioni i pleqërisë për të siguruarit nga neni 118 i këtij ligji, përcaktohet nga baza e pensionit në përqindje të caktuara varësisht nga kohëzgjatja e stazhit të pensionit që për secilin vit stazh të pensionit është 0,75% (mashkull), përkatësisht 0,86% (femër) nga baza e pensionit, ndërsa për stazhin e pensionit më të shkurtër se një vit, e së paku gjashtë muaj është 0,375% (mashkull), përkatësisht 0,43% (femër) nga baza e pensionit.

(2) Pensioni i pleqërisë për të siguruarit nga neni 119 i këtij ligji përcaktohet nga baza e pensionit në përqindje, që për çdo vit stazhi të plotësuar të pensionit deri në pagimin e tyre të kontributit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital janë 2,33% (mashkull), përkatësisht 2,60% (femër), e për stazh të pensionit më të shkurtër se një vit, e së paku gjashtë muaj është 1,165% (mashkull), përkatësisht 1,30% (femër), por më së shumti 11,65% (mashkull), përkatësisht 13,00% (femër) nga baza e pensionit. Për çdo vit të mëtutjeshëm stazh

pensionit të plotësuar pas pagimit të tyre të kontributit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, pensioni përcaktohet në lartësi prej 0,75% (mashkull), përkatësisht 0,86% (femër), ndërsa për stazh pensional më të shkurtër se një vit, e së paku gjashtë muaj është 0,375% (mashkull), përkatësisht 0,43% (femër) nga baza e pensionit.

Shuma më e ulët e pensionit të pleqërisë

Neni 35

(1) Shuma më e ulët e pensionit të pleqërisë e realizuar nga sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës dhe pensionit të realizuar nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital, nuk mund të jetë më pak se rroga e përcaktuar mesatare e të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë në vitin 2002, si vijon:

- për shfrytëzuesit që pensionin e kanë realizuar me stazh pensional mbi 35 vjet (mashkull), përkatësisht mbi 30 vjet (femër), në lartësi prej 41%,
- për shfrytëzuesit që pensionin e kanë realizuar me stazh pensional mbi 25 vjet (mashkull), përkatësisht mbi 20 vjet (femër), në lartësi prej 38% dhe
- për shfrytëzuesit që pensionin e kanë realizuar me stazh pensional deri në 25 vjet (mashkull), përkatësisht deri në 20 vjet (femër), në lartësi prej 35%.

(2) Pensioni nga paragrafi (1) i këtij neni harmonizohet me përqindjen me të cilën harmonizohen pensionet tjera.

Neni 36

I siguruari që do të realizojë pjesë të pensionit sipas marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, e fiton të drejtën për shumë më të ulët të pensionit të pleqërisë nëse shuma e pensionit e përcaktuar sipas këtij ligji dhe pensionit të huaj i llogaritur sipas kursit devizor në fuqi, është më e vogël se shuma nga e cila përcaktohet shuma më e ulët e pensionit nga neni 35 i këtij ligji.

Harmonizimi i pensionit të pleqërisë

Neni 37

(1) Harmonizimi i pensionit të pleqërisë kryhet sipas ndryshimit të indeksit të shpenzimeve të jetës në lartësi prej 50% dhe rritjes së rrogës së paguar mesatare të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë në lartësi prej 50%.

(2) Pensioni nga paragrafi (1) i këtij neni harmonizohet nga 1 janari dhe nga 1 korriku çdo vit sipas përqindjes që fitohet si shumë e rritjes së indeksit të shpenzimeve të jetesës në gjysmëvjetorin paraprak dhe përqindjes së rritjes së rrogës së paguar mesatare të të gjithë të punësuarve në Republikën e Maqedonisë në gjysmëvjetorin paraprak, në raport me gjysmëvjetorin që i paraprin.

(3) Për zbatimin e paragrafit (1) të këtij neni, pensioni i realizuar në vitin rrjedhës paraprakisht reduktohet në shumë mujore sipas rritjes së rrogave nga dhjetori i vitit paraprak në raport me rrogën mesatare në vitin e njëjtë.

Kreu IV

Të drejtat në bazë të invaliditetit

Invaliditeti

Neni 38

(1) Invaliditet ekziston kur te i siguruari, për shkak të ndryshimit në gjendjen shëndetësore që nuk mund të mënjanohet me mjekim ose me rehabilitim mjekësor, aftësia punuese është zvogëluar në mënyrë të përhershme për më shumë se gjysma në krahasim me të siguarin e shëndoshë fizik dhe psikik me arsim dhe aftësim të njëjtë ose të ngjashëm.

(2) Invaliditeti nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet sipas kategorive si vijojnë:

1) kategorija I – nëse aftësia punuese e të siguarit është zvogëluar për më shumë se 80% ekziston humbje e përhershme e aftësisë punuese (paaftësi e përgjithshme për punë) dhe

2) kategorija II – nëse aftësia punuese e të siguarit është zvogëluar për më shumë se 50% ndërsa më së shumti deri 80% (paaftësi profesionale për punë).

(3) Nëse aftësia e punës e të siguarit është zvogëluar për 50% në krahasim me të siguarin e shëndoshë fizik dhe psikik me arsim dhe aftësi të njëjtë ose të ngjashme, për ç'arsye nuk mund t'i kryejë detyrat e punës me orar të plotë të punës, mund të punojë me orar të shkurtuar të punës ose të sistemohet për punë tjetër adekuate në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës dhe marrëveshjen kolektive.

(4) Invaliditeti sipas paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni mund të ndodhë për shkak të sëmundjes, lëndimit jashtë punës, lëndimit gjatë punës ose sëmundjeve profesionale.

(5) Punët për të cilat vlerësohet aftësia për punë e të siguarit i përfshijnë të gjitha punët që korrespondojnë me aftësitë e tij trupore dhe psikike, e konsiderohet se korrespondojnë me punët e tij të deritanishme.

(6) Puna për të cilën vlerësohet aftësia për punë e bujkut individual e përfshin punën në bazë të së cilës është i siguar në mënyrë të detyrueshme, në pajtim me këtë ligj.

Lëndimi gjatë punës

Neni 39

(1) Si lëndim gjatë punës, sipas këtij ligji, konsiderohet lëndimi i të siguarit i shkaktuar me veprim të drejtpërdrejtë dhe afatshkurtër mekanik, fizik ose veprim kimik, si dhe lëndimi i shkaktuar me ndryshime të përnjëhershme të pozicionit të trupit, ngarkim të papritur të trupit ose me ndryshime tjera të gjendjes fiziologjike të organizmit, nëse lëndimi i tillë si shkak është i lidhur me kryerjen e punëve në vendin e punës.

(2) Si lëndim gjatë punës konsiderohet edhe lëndimi i shkaktuar në mënyrën nga paragrafi (1) i këtij neni që i siguruari do ta pësojë në rrugën e rregullt nga banesa deri në vendin e punës ose anasjelltas, në rrugën e marrë për kryerje të detyrave të punës dhe në rrugën e marrë për hyrje në punë, ardhje në punë nga pushimi ose mungesa të ndërprera me urdhër të punëdhënësit, si dhe shfrytëzimin e të drejtës së rehabilitimit profesional sipas këtij ligji.

(3) Si lëndim gjatë punës konsiderohet edhe sëmundja e të siguarit që është shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe si pasojë e jashtëzakonshme e ndonjë rasti të fatkeqësisë ose fuqie madhore gjatë kohës së kryerjes së punës ose në lidhje me atë.

(4) Si lëndim gjatë punës konsiderohet edhe lëndimi që do ta pësojë i siguruari në kryerjen e punëve nga nenet 15 dhe 16 të këtij ligji.

Sëmundja profesionale

Neni 40

(1) Sëmundje profesionale, sipas këtij ligji, janë sëmundje të caktuara të shkaktuara me ndikimin më të gjatë të drejtpërdrejtë të procesit dhe kushteve të punës mbi aftësinë punuese të të siguarit.

(2) Rregulloren për listën e sëmundjeve profesionale e miraton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Invalidi i punës

Neni 41

Invalid i punës, sipas këtij ligji, është i siguruari që në bazë të invaliditetit i realizon të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Rehabilitimi profesional

Neni 42

Kur tek i siguruari është përcaktuar paaftësia profesionale për punë, përcaktohet aftësia tjetër e punës, nëse duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore, vitet e jetës, arsimin dhe aftësinë, me rehabilitim profesional mund të aftësohet për punë me orar të plotë të punës në punë tjetër.

Të drejta në bazë të aftësisë së mbetur të punës

Neni 43

(1) Të drejtë për rehabilitim profesional ka i siguruari te i cili do të ndodh invaliditet para mbarimit të 50 viteve të jetës, nëse sipas aftësisë tjetër punuese mund të aftësohet për punë tjetër me orar të plotë të punës.

(2) Invalidi i punës që ka marrë rehabilitimin profesional aftësohet për kryerjen e punës tjetër adekuate për të cilën nevojitet përgatitja profesionale që korrespondon me punët që i ka kryer në punën e vet para ndodhjes së invaliditetit.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni rehabilitimi profesional mund të sigurohet për punë tjetër për të cilën nevojitet përgatitja profesionale më e lartë nga ajo që korrespondon me punët të cilat i siguruari i ka kryer para ndodhjes së invaliditetit, nëse aftësimi i tillë është i arsyeshëm duke pasur parasysh profesionalizmin, vitet e jetës, përvojën e punës dhe prirjet dhe nëse ekziston mundësi reale për punësim pas aftësimi të mbaruar.

Neni 44

Të drejtë për rehabilitim profesional ka i siguruari nga neni 11 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, te i cili ekziston paaftësi profesionale për punë.

Neni 45

(1) Nëse paaftësia për punë është shkaktuar si pasojë e lëndimit jashtë punës ose sëmundjes, i siguruari ka të drejtë për rehabilitim profesional nëse ka stazh pensional që i mbulon së paku një të tretën e periudhës prej më së shumti 20 vjet të mbushura deri në ditën e ndodhjes së invaliditetit (karrierë), duke e llogaritur karrierën në vite të plota.

(2) Nëse paaftësia profesionale për punë është shkaktuar nga lëndimi në punë ose sëmundja profesionale, i siguruari ka të drejtë për rehabilitim profesional pa marrë parasysh kohëzgjatjen e stazhit pensional.

Neni 46

(1) Të siguruarin me të drejtë rehabilitimi profesional, i cili në afat prej gjashtë muajsh nga dita e përfundimit të aktvendimit për pranimin e të drejtës nuk është dërguar në rehabilitim profesional, Fondi e dërgon në kontroll te Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë për Punë për rivlerësim të aftësisë së mbetur për punë.

(2) Në kontroll për rivlerësim të aftësisë së mbetur për punë do të dërgohet edhe i siguruari me të drejtë rehabilitimi profesional, kur Fondi do të vlerësojë se nuk do të mund të aftësohet për punë në vendin e punës të caktuar më parë.

(3) Iniciativë për kontroll të të siguarit në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund të japë edhe punëdhënësi.

Neni 47

(1) I siguruari që ka e fituar të drejtën për rehabilitim profesional, nga dita e shkaktimit të invaliditetit deri në ditën e fillimit të rehabilitimit profesional, gjatë kohës së rehabilitimit profesional dhe nga dita e përfundimit të rehabilitimit profesional deri në punësimin në vendin adekuat të punës, ka të drejtë kompensimi të rrogës në lartësi të pensionit invalidor në rast të paaftësisë profesionale për punë. Lartësia e pensionit invalidor caktohet në raste të lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale në lartësi prej 80% të bazës pensionale për përcaktimin e pensionit invalidor dhe në raste të lëndimit jashtë pune ose sëmundjes, në lartësi të pensionit invalidor të shkaktuar nga paaftësia profesionale për punë.

(2) Kompensimi i rrogës nga paragrafi (1) i këtij neni i takon invalidit të punës më së shumti 12 muaj nga dita e përfundimit të rehabilitimit profesional me kusht që në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të rehabilitimit profesional, të paraqitet në shërbimin kompetent për punësim dhe në pajtim me rregullat për punësim rregullisht të paraqitet te ai shërbim.

(3) Kur rehabilitimi profesional kryhet jashtë vendqëndrimit të invalidit të punës dhe nuk mund të sigurohet transport i rregullt nga vendbanimi deri në vendin ku kryhet rehabilitimi profesional, për invalidin sigurohet vendqëndrim dhe ushqim ose kompensim për vendqëndrim dhe ushqim gjatë kohës së rehabilitimit profesional në vend tjetër, të cilin e cakton Fondi me akt të përgjithshëm.

Neni 48

Rehabilitimi profesional kryhet në kushte dhe mënyrë sipas të cilave aftësohen edhe të punësuarit tjerë te punëdhënësi ose te qendra për rehabilitim.

Neni 49

Nëse i siguruari punësohet ose nëse i plotëson kushtet për realizimin e të drejtës për pension sipas pleqërisë, invaliditetit ose pensionit familjar e drejta për kompensim me para i ndërpritet.

Pensioni invalidor

Neni 50

(1) I siguruari te i cili do të shkaktohet paaftësi e përgjithshme për punë, si dhe i siguruari me aftësi të mbetur për punë i cili për shkak të përfundimit të viteve të caktuara të jetës, me rehabilitim profesional nuk mund të aftësohet për kryerjen e një pune tjetër adekuate e fiton të drejtën e pensionit invalidor nëse i plotëson kushtet si vijojnë:

1) invaliditeti është shkaktuar me lëndim në punë ose sëmundje profesionale - pa marrë parasysh gjatësinë e stazhit pensional ose

2) invaliditeti është shkaktuar me lëndim jashtë pune ose sëmundje me kusht që para shkaktimit të invaliditetit, përkatësisht në ditën e ndërprerjes së sigurimit pas invaliditetit të shkaktuar të jetë më i vjetër se 45 vjet dhe të ketë plotësuar së paku 12 vite stazh pensional ose

3) invaliditeti është shkaktuar me lëndim jashtë vendit të punës ose me sëmundje nëse i siguruari i ka mbushur mbi 30 deri 37 vjet jetë, duhet të ketë stazh pensional që i mbulon 30% të karrierës, duke e llogaritur karrierën në vite të plota, dhe i siguruari i ka mbushur 37 deri 45 vjet jetë, duhet të ketë stazh pensional që i mbulon 40% të karrierës, duke e llogaritur karrierën në vite të plota.

(2) I siguruari te i cili invaliditeti është shkaktuar para përfundimit të 30 viteve jetë si pasojë e lëndimit jashtë pune ose sëmundjes, e merr të drejtën e pensionit invalidor nëse në ditën e shkaktimit të invaliditetit ka pasur cilësi të të siguarit ose nëse:

1) invaliditeti është shkaktuar deri në plotësimin e 20 viteve jetë, nëse ka pasur së paku gjashtë muaj stazh të sigurimit;

2) invaliditeti është shkaktuar deri në plotësimin e 25 viteve jetë, nëse ka pasur së paku dhjetë muaj stazh të sigurimit dhe

3) invaliditeti është shkaktuar deri në plotësimin e 30 viteve jetë, nëse ka pasur së paku 12 muaj stazh të sigurimit.

(3) I siguruari - invalid i luftës nga grupi I deri në grupin VI, si dhe invalid tjetër i cili është i barazuar me invalidët e luftës në kohë paqeje nga grupi V deri në grupin VI, te i cili sipas nenit 38 të këtij ligji konstatohet invaliditet nuk mund të punojë më shumë se gjysma e orarit të plotë të punës, e merr të drejtën e pensionit invalidor nëse i plotëson kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, pa marrë parasysh nëse me ose pa rikualifikim ose kualifikim plotësues mund të aftësohet për punë tjetër adekuate.

(4) Si karrierë sipas paragrafit (1) pika 3 të këtij neni për të siguarin i cili me shkollim të rregullt ka marrë përgatitje të lartë profesionale, përkatësisht përgatitje sipërore profesionale konsiderohet koha nga mbushja e 23, përkatësisht 26 viteve deri në ditën e shkaktimit të invaliditetit.

(5) Të siguarit i cili pas mbushjes së 20 viteve jetë ka qenë në kryerje të shërbimit ushtarak, karriera i zvogëlohet për kohën sa ka zgjatur shërbimi i kryer ushtarak.

Neni 51

(1) Pensioni invalidor përcaktohet nga baza pensionale që përcaktohet në mënyrë të paraparë në nenet nga 20 deri 33 të këtij ligji.

(2) Për të siguruarit nga nenet 15 dhe 16 të këtij ligji bazen pensionale e përcakton Fondi me akt të përgjithshëm.

Neni 52

(1) Pensioni invalidor në raste të invaliditetit të shkaktuar me lëndim në punë ose sëmundje profesionale përcaktohet në lartësi prej 80% të bazës pensionale për pensionin e realizuar deri në vitin 2015, ndërsa pensioni invalidor pas vitit 2015 përcaktohet në përqindje, si vijon:

Viti	Përqindja
2016	79.68
2017	79.36
2018	79.04
2019	78.72
2020	78.40
2021	78.08
2022	77.76
2023	77.44
2024	77.12
2025	76.80
2026	76.48
2027	76.16
2028	75.84
2029	75.52
2030	75.20
2031	74.88
2032	74.56
2033	74.24
2034	73.92
2035	73.60
2036	73.28
2037	72.96
2038	72.64
2039	72.32
2040	72.00

(2) Pensioni invalidor në rast të invaliditetit të shkaktuar me sëmundje ose lëndim jashtë pune përcaktohet nga baza pensionale në përqindje sipas nenit 228 të këtij ligji.

(3) Pensioni invalidor i përcaktuar sipas paragrafit (2) të këtij neni, në raste të invaliditetit të shkaktuar para mbushjes së viteve të jetës nga neni 18 i këtij ligji, nuk mund të jetë më pak se përqindjet e përcaktuara për vitin në të cilin është realizuar e drejta e pensionit, si vijon:

Viti	Përqindje	
	mashkull	femër
2000	44.00	53.00
2001	43.60	52.40
2002	43.20	51.80
2003	42.80	51.20

2004	42.40	50.60
2005	42.00	50.00
2006	41.60	49.40
2007	41.20	48.80
2008	40.80	48.20
2009	40.40	47.60
2010	40.00	47.00
2011	39.60	46.40
2012	39.20	45.80
2013	38.80	45.20
2014	38.40	44.60
2015	38.00	44.00
2016	37.60	43.40
2017	37.20	42.80
2018	36.80	42.20
2019	36.40	41.60
2020	36.00	41.00

(4) Pensioni invalidor i percaktuar sipas paragrafit (2) të ketij neni, në raste të invaliditetit të shkaktuar pas mbushjes së viteve të jetes nga neni 18 i ketij ligji, nuk mund të jete më pak se perqindjet e percaktuara për vitin në të cilin është realizuar e drejta e pensionit, si vijon:

Viti	Perqindje	
	mashkull	femer
2000	35.00	40.00
2001	34.47	39.38
2002	33.93	38.77
2003	33.40	38.15
2004	32.87	37.53
2005	32.33	36.92
2006	31.80	36.30
2007	31.27	35.68
2008	30.73	35.07
2009	30.20	34.45
2010	29.67	33.83
2011	29.13	33.22
2012	28.60	32.60
2013	28.07	31.98
2014	27.53	31.37
2015	27.00	30.75

(5) Të siguruarit invalid i luftes nga grupi I deri IV, si dhe invalidit tjetër i cili është i barabartë me invalidin e luftes në kohë paqeje nga grupi I deri IV, i cili do të marrë të drejtën e pensionit invalidor, pensioni i percaktohet sipas paragrafit (1) të ketij neni, nëse gjysma e karrierës i është mbuluar me stazhin pensional.

Neni 53

(1) Shfrytëzuesit të pensionit invalidor të i cili është shkaktuar humbje e aftësisë për punë para plotësimit të viteve të jetes nga neni 18 i ketij ligji dhe të cilit pensioni i është caktuar sipas nenit 52 paragrafi (3) të ketij ligji, është më pak se pensioni i caktuar sipas nenit 52 paragrafi (1) të ketij ligji, i takon edhe shtese invalide.

(2) Shtesa invalide i percaktohet shfrytezuesit të pensionit invalidor nga grupi I, si vijon:

1) 10% nga shuma e pensionit invalidor nese i eshte percaktuar paaftesi e pergjithshme për pune me percaktimin e 80% të invaliditetit;

2) 15% nga shuma e pensionit invalidor nese i eshte percaktuar paaftesi e pergjithshme për pune me percaktimin e 90% të invaliditetit dhe

3) 20% nga shuma e pensionit invalidor nese i eshte percaktuar paaftesi e pergjithshme për pune me percaktimin e 100% të invaliditetit.

(3) Pensioni invalidor së bashku me shtesen invalide nuk mund të jete më shume se pensioni i percaktuar sipas nenit 52 paragrafit (1) të ketij ligji.

(4) Shtesa invalide eshte pjese perberese e pensionit invalidor.

Neni 54

(1) Nese invaliditeti në baze të të cilit i siguruari e fiton të drejten e pensionit invalidor eshte shkaktuar pjeserisht me lendim në pune ose me semundje profesionale, dhe pjeserisht me semundje ose me lendim jashte pune, pensioni invalidor percaktohet si një pension që perbehet nga pjesa e proporcionale e pensionit invalidor e llogaritur si për rast të lendimit në pune ose semundjes profesionale dhe pjesa proporcionale e pensionit invalidor të llogaritur si për raste të semundjes ose lendimit jashte pune.

(2) Fondi me Statut më afersisht e rregullon menyren e percaktimit të pensionit invalidor në rastet nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 55

(1) I siguruari që i ploteson kushtet për fitimin e të drejtes së pensionit invalidor ka të drejte për shumen më të ulet të pensionit invalidor.

(2) Shuma më e ulet e pensionit invalidor percaktohet në menyre të percaktuar me nenin 35 të ketij ligji.

Neni 56

Dispozitat e ketij ligji për harmonizimin e pensionit të pleqerise zbatohen edhe në pensionin invalidor.

Kreu V

Pensioni familjar

Neni 57

(1) Pension familjar mund të realizojnë anëtarët e familjes:

1) bashkëshorti-ja;

2) fëmijët (të lindur në martesë ose jashtëmartesorë ose të adoptuar; të birësuarit për të cilët është perkujdesur i siguruari, nipërit dhe fëmijë të tjerë pa prindër që i ka mbajtur i siguruari) dhe

3) prindërit (nëna dhe babai, njerku dhe njerka) dhe adoptuesi, që i ka mbajtur i siguruari.

(2) Pension familjar mund të realizojë edhe bashkëshorti-ja nga martesja e shkurorëzuar, nëse me vendim gjyqësor i është percaktuar e drejta për mbajtje.

(3) Konsiderohet se për nipërit pa prindër, fëmijët tjerë pa prindër dhe për prindërit i ka mbajtur i siguruari sipas paragrafit (1) pikat 2 dhe 3 të ketij neni, nëse në atë periudhë:

1) nuk kanë qenë në marrëdhënie pune ose nuk kanë realizuar rrogë në bazë tjetër;

2) nuk kanë qenë shfrytëzues të pensionit të pleqërisë, invalidor dhe pensionit familjar;

3) të hyrat kadastrale nga veprimtaria bujqësore për anëtarë të familjes më të ngushtë ose më të gjerë, nuk janë për vit më shumë se 25% nga rroga mesatare e realizuar në Republikë në vitin paraprak dhe

4) të gjitha të hyrat tjera për çdo anëtar të familjes nuk janë për muaj më shumë se 25% nga rroga mesatare e realizuar në Republikë në vitin paraprak.

Neni 58

(1) Anëtarët e familjes e fitojnë të drejtën për pension familjar nëse i siguruari i vdekur:

- 1) i ka mbushur së paku pesë vite stazh të sigurimit ose së paku dhjetë vite stazh pensional ose
- 2) i ka plotësuar kushtet për pension të pleqërisë ose invalidor, ose
- 3) ka qenë shfrytëzues i pensionit të pleqërisë ose i pensionit invalidor.

(2) Nëse vdekja e të siguarit është shkaktuar si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale, anëtarët e familjes e fitojnë të drejtën e pensionit familjar, pa marrë parasysh gjatësinë e stazhit pensional të të siguarit.

Neni 59

(1) Vejani/vejusha e fiton të drejtën e pensionit familjar, nëse:

1) deri në vdekjen e të siguarit, në bazë të së cilës ajo e drejtë i takon, personi i ka mbushur 50 vjet;

2) deri në vdekjen e bashkëshortit ka qenë i paaftë për punë ose paaftësia e tillë i është shkaktuar në afat prej një viti nga dita e vdekjes së bashkëshortit;

3) pas vdekjes së bashkëshortit kanë mbetur një ose më shumë fëmijë të cilët kanë të drejtë për pension familjar sipas atij bashkëshorti, ndërsa vejani/vejusha i kryen obligimet e prindit ndaj atyre fëmijëve ose

4) deri në vdekjen e bashkëshortit i ka pasur të mbushura 45 vjet, kur do t'i mbushë 50 vjet - ose nëse në ato vite është bërë i paaftë për punë.

(2) Vejani/vejusha që gjatë shfrytëzimit të së drejtës në bazë të kryerjes së detyrës së prindit nga paragrafi (1) pika 3 e këtij neni, bëhet i paaftë për punë ose i ka mbushur 50 vjet, në mënyrë të përhershme e mban të drejtën për pension familjar.

(3) Vejani/vejusha që e ka humbur të drejtën për pension familjar në bazë të kryerjes së obligimit prindëror pas mbushjes së 45 viteve, e fiton të drejtën për pension familjar kur do t'i mbushë 50 vjet.

Neni 60

(1) Të drejtë për pension familjar fiton edhe vejusha kur fëmija i të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit të pensionit ka lindur pas vdekjes së të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit të pensionit, me atë që pensioni familjar i takon nga dita e vdekjes së të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit të pensionit.

(2) Të drejtë për pension familjar fiton edhe vejusha te e cila ka ekzistuar shtatzëni në ditën e vdekjes së të siguarit, përkatësisht të shfrytëzuesit të pensionit me atë që pensioni familjar deri në lindjen e fëmijës përcaktohet për një anëtar të familjes.

(3) Nëse fëmija lind i vdekur ose nëse vdes para përfundimit të 45 ditëve jetë, vejushës i takon pension familjar deri në kalimin e 45 ditëve pas lindjes.

Neni 61

(1) Fëmija e fiton, përkatësisht shfrytëzon të drejtën e pensionit familjar:

1) deri në mbushjen e 15 viteve jetë, e nëse është në shkollim deri në mbushjen e 26 viteve ose

2) nëse para vdekjes së të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit të pensionit i cili e ka mbajtur, ka qenë i paaftë për punë ose paaftësia e tillë është shkaktuar në afat prej një viti nga dita e vdekjes së të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit të pensionit.

(2) Nëse shkollimi i fëmijës është ndërprerë për shkak të sëmundjes, të drejtë të pensionit familjar mund të fitojë, përkatësisht i takon edhe gjatë kohës së pushimit mjekësor deri në mbushjen e 26 viteve, si dhe mbi ato vite, por më së shumti për aq kohë sa është humbur nga shkollimi i rregullt për shkak të sëmundjes.

(3) Fëmijës që e ka ndërprerë shkollimin për shkak të kryerjes së shërbimit vullnetar ushtarak, pensioni familjar i paguhet edhe gjatë asaj kohe.

(4) Nëse gjatë shfrytëzimit të së drejtës së pensionit familjar fëmija bëhet i paaftë për punë, e mban të drejtën e përhershme të pensionit familjar.

(5) Fëmija - invalid ka të drejtë për pension familjar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Neni 62

(1) Si fëmijë në shkollim sipas nenit 61 të këtij ligji, konsiderohet nxënësi në shkollë fillore, shkollë për arsim të mesëm, aftësim profesional përkatësisht të punës, studenti në institucionin e lartë arsimor dhe personi në studimet pasuniversitare derisa e ka statusin e nxënësit, përkatësisht studentit sipas statusit të institucionit adekuat edukativo-arsimor deri në mbushjen e 26 viteve.

(2) Si shkollim i fëmijës sipas paragrafit (1) të këtij neni llogaritet kohëzgjatja e aftësimi profesional, përkatësisht të punës së fëmijëve me pengesa në zhvillimin psikofizik.

(3) Si fëmijë pa prindër sipas nenit 57 paragrafit (1) pika 2 të këtij ligji, konsiderohet edhe fëmija që ka një ose dy prindër të cilët janë të paaftë për punë në mënyrë të përhershme.

Neni 63

Prindi të cilin i siguruari, përkatësisht shfrytëzuesi i pensionit e ka mbajtur deri në fund të jetës së vet, e fiton të drejtën e pensionit familjar nëse:

1) deri në vdekjen e të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit të pensionit i ka mbushur 55 vjet dhe

2) është më i ri se 55 vjet, dhe nëse deri në vdekjen e të siguarit, përkatësisht shfrytëzuesit të pensionit ka qenë i paaftë për punë.

Neni 64

Si paaftësi për punë në bazë të së cilës realizohet e drejta e pensionit familjar, te fëmijët konsiderohet paaftësia për jetë dhe punë të pavarur, ndërsa te personat tjerë ekzistimi i aftësisë së humbur për punë.

Neni 65

(1) E drejta e pensionit familjar u takon së pari bashkeshortit-es dhe femijeve të të siguarit, perkatesisht shfrytezuesit të pensionit (në tekstin e metejme: anetareve të familjes më të ngushte).

(2) Prinderit, adoptuesit, nipërit dhe femije tjere pa prinder që i ka mbajtur i siguruari, perkatesisht shfrytezuesi i pensionit (në tekstin e metejme: anetaret e familjes më të gjere), kane të drejte për pension familjar nese i siguruari, perkatesisht shfrytezuesi i pensionit nuk ka pasur anetare të familjes më të ngushte të cilet kane të drejte për pension familjar ose nese pensioni i cili u takon anetareve të familjes më të ngushte nuk e shter shumen e plote të bazes nga e cila percaktohet pensioni familjar.

Neni 66

(1) Pensioni familjar percaktohet nga pensioni i pleqerise ose pensioni invalidor që siguresit do t'i takonte në momentin e vdekjes, perkatesisht nga pensioni që shfrytezuesit të pensionit i ka takuar në momentin e vdekjes.

(2) Pensioni familjar nga pensioni i pleqerise percaktohet nga baza pensionale në perqindje varesisht nga gjatesia e stazhit pensional të percaktuar në nenin 228 të ketij ligji.

(3) Lartesia e pensionit familjar percaktohet në perqindje të bazes që e perbejne pensioni i pleqerise ose pensioni invalidor si vijon, 70% për një anetar të familjes, ndersa për çdo anetar të ardhshem edhe nga 10%, por jo më shume se 100% të bazes.

(4) Femijeve pa dy prinder, pensioni familjar i realizuar sipas njerit prind u rritet për një pjese të pensionit që e ka shfrytezuar ose që do ta kishte shfrytezuar prindi tjetër, si vijon:

1) për dy femije.....20%

2) për tre femije.....30% dhe

3) për kater ose më shume femije.....40%.

(5) Kur pensionin familjar e shfrytezojne tre ose më shume anetare të familjes, lartesia e pensionit familjar nuk mund të jete më pak se 40% të baze së pensionit të të siguruarit të vdekur.

(6) Si baze për percaktimin e pensionit familjar nga siguruesi i cili ka stazh pensional më pak se 15 vjet, e nuk i ploteson kushtet për pension invalidor, merret pensioni i pleqerise i llogaritur për stazh pensional prej 15 vitesh.

Neni 67

(1) Nese pensioni u takon anetareve të familjes më të ngushte dhe anetareve të familjes më të gjere, anetareve të familjes më të ngushte u caktohet pension familjar sipas perqindjeve të parapara në nenin 66 paragrafin (1) të ketij ligji, ndersa anetareve të familjes më të gjere u takon pjesa tjetere e shumës së plote të baze së pensionit familjar.

(2) Nese të drejte për pension familjar ka edhe bashkeshorti i shkurorëzuar, caktohet një pension familjar për bashkeshortin nga martesë e re dhe për bashkeshortin e shkurorëzuar në lartesi që i takon një personi të familjes.

Neni 68

(1) Anetaret e familjes së të siguruarit ose shfrytezuesit të pensionit kane të drejte për shumën më të vogël të pensionit familjar.

(2) Shuma më e vogël e pensionit familjar percaktohet në lartesi të shumës më të ulët të pensionit të pleqerise, perkatesisht shumës më të larte të pensionit invalidor varesisht prej baze nga e cila eshte percaktuar pensioni familjar.

(3) Dispozitat e ketij ligji për harmonizimin e pensionit të pleqerise kane të bejne me pensionin invalidor.

Kreu VI

Kompensimi me para për demtim trupor

Neni 69

(1) Demtim trupor ekziston kur te i siguruari do të shkaktohet humbje, demtim më esencial ose paaftesi më e theksuar e organeve të caktuara ose pjeseve të trupit që e rendon aktivitetin normal të organizmit dhe kerkon mund më të madh për realizimin e nevojave jetesore, pa dallim nese shkakton ose nuk shkakton invaliditet.

(2) I siguruari te i cili demtimi trupor do të shkaktohet gjate kohezgjatjes së sigurimit e fiton të drejten e kompensimit me para për demtim trupor, në kushtet e njejta në pikepamje të stazhit pensional me të cilat e fiton të drejten e pensionit invalidor.

(3) Rregulloren për Listen për llojet e demtimeve trupore në baze të të cilave fitohet e drejta e kompensimit me para dhe perqindjet e tyre demtimeve, e miraton ministri i Punes dhe Politikës Sociale, pas mendimit të marre paraprakisht nga Instituti për Mjekesi të Punes.

Neni 70

(1) Të drejte për kompensim me para për demtim trupor i siguruari fiton pavaresisht nese ka fituar dhe shfrytezuar ndonje të drejte tjetere të sigurimit pensional dhe invalidor.

(2) I siguruari nuk e fiton të drejten e kompensimit me para për demtim trupor prej 30 deri 40% sipas listes së demtimeve trupore, që eshte shkaktuar si pasoje e semundjes ose lendimit jashte pune, për demtim trupor që ka ekzistuar para hyrjes në marrëdhënie pune, si dhe perkeqesimin e mevonshem të atij demtimi trupor. Me perjashtim kur para hyrjes në marrëdhënie pune ka ekzistuar demtim trupor i njerit nga organet çift, dhe më vone fillon demtimi i organit tjetere të permendur, i siguruari e fiton të drejten për kompensim me para për demtim trupor të dy organeve.

Neni 71

Lartesia e kompensimit me para për demtim trupor percaktohet sipas perqindjes së percaktuar të demtimit trupor sipas bazave si vijojne:

- 9% e rrogës mesatare të realizuar në Republike në vitin paraprak kur demtimi trupor është shkaktuar me lëndim në punë ose me sëmundje profesionale dhe
- 7% e rrogës mesatare të realizuar në Republike në vitin paraprak kur demtimi trupor është shkaktuar me sëmundje ose lëndim jashtë punë.

Neni 72

(1) Nëse ekzistojnë dy ose më shumë demtime trupore perqindja e përgjithshme percaktohet në atë mënyrë që në perqindjen më të madhe shtohet, si vijon:

- 1) nga 20% për çdo demtim trupor të mëtejme prej 50% ose më shumë dhe
- 2) nga 10% për çdo demtim trupor të mëtejme prej 40% dhe 30%.

(2) Nëse lëndimet trupore kanë ekzistuar për arsye të ndryshme perqindja do të caktohet sipas paragrafit (1) të këtij neni, ndërsa kompensimi me para do të caktohet nga baza e perqindjes më të madhe të demtimit trupor.

(3) Perqindja e përgjithshme e demtimit trupor për pikat 1 dhe 2 të paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të jetë më shumë se 100%.

Neni 73

Shfrytëzuesit të kompensimit me para për demtim trupor në raste të perkeqesimit të demtimit ekzistues trupor ose rastit të ri të demtimit trupor, i caktohet kompensim me para sipas perqindjes së re ose perqindjes së përgjithshme të demtimit trupor.

Neni 74

Nëse i siguruari për rast të njëjtit të demtimit trupor e fiton të drejtën e kompensimit me para për demtim trupor sipas rregullave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe të drejtën e invaliditetit si invalid i luftës në kohë paqëje sipas rregullave për invalidet e luftës, mund të shfrytëzojë vetëm një nga ato të drejta, me zgjedhje personale.

Neni 75

Dispozitat e këtij ligji për harmonizimin e pensionit të pleqërisë zbatohen edhe në kompensimin me para për demtim trupor.

Kreu VII

Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguruarve me kushte të vecanta

Të siguruarit nga mbrojtja

Neni 76

Të siguruarve nga neni 11 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji, stazhi i sigurimit u llogaritet me kohezgjatje të shtuar, si vijon:

1) çdo 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive në ato detyra llogariten si 18 muaj stazh të sigurimit në:

a) shërbim të aviacionit - me detyrë pilot aktiv, vëzhgues, radiotelegrafist, automekanik, aerofotograf ose detyra tjera për të cilat kanë kryer shërbim fluturimi ose si pjesëtar i organit të shërbimit sanitar të testimit dhe trajnimit të aviatorëve ose për testimin e pajisjes mbrojtëse në barokomora, perkatesisht avione, nëse gjatë testimit dhe trajnimit të atillë kanë fluturuar së paku 90 orë në vit;

b) shërbim parashutisti - në detyra parashutist aktiv;

v) detyre të zhytesit dhe

g) detyra të njesive për dedikim special;

2) çdo 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive në këto detyra llogariten si 16 muaj stazh i sigurimit në:

a) kryerjen e punëve të anëtarit të ekuipazhit eksperimental special për testimin e armatimit në fazën e fitimit të prodhimit dhe testimin dhe eksperimenteve të thellë, nëse në eksperimentet dhe testimet kalon mesatarisht së paku gjysma e orarit të përgjithshëm vjetor të punës;

b) kryerjen e punëve të mbrojtjes radiologjike, biologjike dhe kimike në shërbimet laboratorike dhe të poligonit, që do t'i përcaktoje ministri i Mbrojtjes dhe

v) kryerjen e punëve të mbrojtjes elektronike dhe punëve të kriptombrojtjes, sigurojë se punëve të zbulimit dhe kundërzbulimit dhe policisë ushtarake dhe

3) çdo 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive në ato detyra llogariten si 15 muaj stazh i sigurimit në:

a) kryerjen e punëve të pajisjeve të radarit në të cilat janë ekspozuar në rrezatime të radarit edhe atë: personi i cili kryen rregullim, rregullime dhe hetime më të nderlikuara ose punon si instruktor - arsimtar për rregullimin e pajisjeve të radarit, nëse në ato punë kalon mesatarisht së paku 3/4 nga orari i përgjithshëm vjetor i punës dhe

b) kryerja e detyrës në trupin të thellë me brigadë dhe njësi adekuate dhe detyra të caktuara në komandë të korpusit dhe institucionet ushtarake në të cilat shërbimi kryhet nën shërbimet e trupave, ndërsa të cilat i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 77

I siguruari nga neni 11 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji i cili ka së paku 25 vjet stazh pensional prej të cilave së paku 15 vjet të kaluara në mënyrë efektive në vendet e punës për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar dhe 55 vjet (mashkull) përkatësisht 50 vjet moshe (femer), nëse marrëdhënia e punës i perfundon sipas nevojës së shërbimit, mund ta fitojë të drejtën e pensionit të pleqërisë.

Neni 78

(1) Të siguruarve nga neni 11 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji pensioni i pleqërisë u përcaktohet nga baza pensionale në përqindje si shumë e kohezgjatjes së stazhit pensional të mbushur deri më 31 dhjetor 2012 dhe pas 1 janarit 2013.

(2) Të siguruarve nga paragrafi (1) i këtij neni të cilët deri më 31 dhjetor 2012 kanë mbushur stazh pensional prej 25 vitesh, për çdo vit të ardhshëm u përcaktohet përqindje nga baza pensionale që është 1,08 (mashkull) dhe 1,29 (femer).

(3) Të siguruarve nga paragrafi (1) i këtij neni të cilët deri më 31 dhjetor 2012 nuk kanë mbushur stazh pensional prej 25 vitesh, pas kësaj date u caktohet përqindje e cila deri në mbushjen e stazhit pensional prej 25 vitesh për çdo vit është 2,22% të bazës pensionale për mashkull, përkatësisht 2,35% të bazës pensionale për femer. Për çdo vit stazhi pensional i cili është mbi 25 vite shtohen në mënyrë plotësuese 1,08% të bazës pensionale për mashkull, përkatësisht 1,29% të bazës pensionale për femer.

(4) Për të siguarit nga paragrafet (2) dhe (3) të këtij neni përqindja për përcaktimin e pensionit të pleqërisë është 2,48% për mashkull dhe 2,62% për femer për çdo vit stazhi pensional deri më 31 dhjetor 2012.

Neni 79

Të siguarit nga neni 11 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji të cilit stazhi i sigurimit i llogaritet me kohezgjatje të shtuar, kufiri i moshës për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë i zvogëlohet, varesisht nga shkalla e rritjes së stazhit për nga një vit, si vijon:

1) për çdo gjashtë vjet të kaluar në vendet e punes në të cilat 12 muajt e kaluar në menyre efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 14 muaj;

2) për çdo pese vjet të kaluar në vendet e punes në të cilat 12 muajt e kaluar në menyre efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 15 muaj;

3) për çdo kater vjet të kaluar në vendet e punes në të cilat 12 muajt e kaluar në menyre efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 16 muaj dhe

4) për çdo tre vite të kaluara në vendet e punes në të cilat 12 muajt e kaluar në menyre efektive llogariten në stazhin e sigurimit si 18 muaj.

Neni 80

Për të siguruarit nga neni 11 paragrafi (1) pika 2 të këtij ligji për percaktimin e pensionit invalidor sipas gjatesise së stazhit pensional zbatohen perqindjet nga neni 78 i këtij ligji.

Neni 81

Dallimi ndermjet pensionit të percaktuar pa zbatimin e neneve prej 76 deri 80 të këtij ligji dhe pensionit të percaktuar me zbatimin e ketyre neneve, si dhe tere shuma e pensionit e percaktuar për të siguruarin i cili nuk i ploteson kushtet e pergjithshme për realizimin e të drejtes së pensionit pa zbatimin e ketyre neneve, sigurohet nga Buxheti i Republikes së Maqedonise. Mjetet për pjesen e pensionit për stazhin e mbaruar në ish-Armaten Popullore të Jugosllavise deri më 1 prill 1992, i siguron Buxheti i Republikes së Maqedonise.

Të siguruarit nga punet e brendshme dhe nga institucionet ndeshkuese-permiresuese dhe shtepite edukuese-permiresuese

Neni 82

(1) Personave të autorizuar zyrtare, sipas dispozitave për kryerjen e puneve të brendshme, stazhi i sigurimit u llogaritet me kohezgjatje të rritur edhe atë çdo 12 muaj të kaluar në menyre efektive për ato detyra llogariten si 16 muaj stazh i sigurimit.

(2) Të drejte për stazh të sigurimit me kohezgjatje të rritur sipas paragrafit (1) të këtij neni kane edhe të punesuarit në Ministrine e Puneve të Brendshme që punojne në vendet e punes rendesia e të cilave dhe kushtet e vecanta në të cilat ato kryhen ndikojne mbi zvogelimin e aftesise së punes.

(3) Vendet e punes nga paragrafi (2) i këtij neni, i percakton Qeveria e Republikes së Maqedonise me propozim të ministrit të Puneve të Brendshme.

(4) Dispozitat e paragrafeve (1) dhe (3) të këtij neni nuk kane të bejne me kohen derisa punetori gjendet në arsim ose persosje profesionale ku eshte derguar nga Ministria e Puneve të Brendshme, në disponim ose eshte sistemuar për shkak të nderpreprjes së vendeve të punes ose zvogelimit për kohe më të gjate të vellimit të detyrave të punes.

Neni 83

I punesuari në Ministrine e Puneve të Brendshme i cili ka së paku 25 vjet stazh pensional prej të cilave së paku 15 vjet të kaluara në menyre efektive në vendet e punes për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur dhe 55 vjet (mashkull), perkatesisht 50 vjet moshe (femer), mund ta realizoje të drejten e pensionit të pleqerise, nese marredhenia e punes i nderpritet sipas nevojës së sherbimit.

Neni 84

(1) Punetoreve të autorizuar në pajtim me dispozitat për zbatimin e sanksioneve, stazhi i sigurimit u llogaritet me kohezgjatje të rritur edhe atë çdo 12 muaj të kaluar në menyre efektive në ato detyra në institucione ndeshkuese permiresuese dhe shtepi edukuese permiresuese, u llogariten si 16 muaj stazh i sigurimit.

(2) Të drejte për stazh të sigurimit me kohezgjatje të rritur sipas paragrafit (1) të ketij neni kane edhe të punesuarit në Ministrine e Drejtesise, institucionet ndeshkuese permiresuese dhe shtepite edukuese permiresuese që punojne në vendet e punes rendesia e të cilave dhe kushtet e vecanta në të cilat ato kryhen, ndikojne mbi zvogelimin e aftesise së punes.

(3) Dispozitat e paragrafeve (1) dhe (2) të ketij neni nuk kane të bejne me kohen derisa i punesuari gjendet në arsim ose persosje profesionale ku eshte derguar nga institucioni ndeshkues-permiresues, perkatesisht shtepia edukuese-permiresuese.

Neni 85

Punetori në Ministrine e Drejtesise, institucion ndeshkues-permiresues dhe shtepi edukuese-permiresuese, që ka së paku 25 vjet stazh pensional prej të cilave së paku 15 vjet të kaluara në menyre efektive në vendet e punes për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur sipas nenit 94 paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni dhe 55 vjet (mashkull), perkatesisht 50 vjet (femer), mund ta realizoje të drejten e pensionit të pleqerise, nese marredhenia e punes i nderpritet sipas nevojës së sherbimit.

Neni 86

Pension në kushte të vecanta mund të realizoje i punesuari në Ministrine e Puneve të Brendshme si dhe i punesuari në Ministrine e Drejtesise, institucion ndeshkues permiresues dhe shtepi edukuese permiresuese, i cili edhe pse në momentin e realizimit të së drejtes nuk eshte në vendet e punes ku stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur, ka së paku 25 vjet stazh pensional prej të cilave së paku 15 vjet të kaluara në menyre efektive në vendet e punes ku stazhi i sigurimit u llogaritet me kohezgjatje të rritur dhe 55 vjet për mashkull perkatesisht 50 vjet për femer, nese marredhenia e punes i nderpritet sipas nevojës së sherbimit.

Neni 87

(1) Punetoreve nga nenet 82, 84 dhe 86 të ketij ligji pensioni i pleqerise u percaktohet nga baza pensionale në perqindje si shume e gjatesise së stazhit pensional të mbaruar deri më 31 dhjetor 2012 dhe pas 1 janarit 2013.

(2) Të siguruarve nga paragrafi (1) i ketij neni të cilet deri më 31 dhjetor 2012 kane mbushur stazh pensional prej 25 vitesh, për çdo vit të ardhshem u percaktohet perqindje nga baza pensionale që eshte 1,08 (mashkull) dhe 1,29 (femer).

(3) Të siguruarve nga paragrafi (1) i ketij neni të cilet deri më 31 dhjetor 2012 nuk kane mbushur stazh pensional prej 25 vitesh, pas kesaj date u caktohet perqindje e cila deri në mbushjen e stazhit pensional prej 25 vitesh për çdo vit arrin 2,22% të bazes pensionale për mashkull perkatesisht 2,35% të bazes pensionale për femer. Për çdo vit stazhi pensional i cili eshte mbi 25 vite shtohen në menyre plotesuese 1,08% të bazes pensionale për mashkull, perkatesisht 1,29% të bazes pensionale për femer.

(4) Për të siguruarit nga paragrafet (2) dhe (3) të ketij neni perqindja për percaktimin e pensionit të pleqerise eshte 2,48% për mashkull dhe 2,62% për femer për çdo vit stazhi pensional deri më 31 dhjetor 2012.

Neni 88

Për punetoret nga nenet 82, 84 dhe 86 të ketij ligji për percaktimin e pensionit invalidor sipas gjatesise së stazhit pensional zbatohen perqindjet nga neni 87 i ketij ligji me ç'rast si perqindje më e ulet deri në mbushjen e 25 viteve percaktohet 62,0% të bazes pensionale për mashkull, perkatesisht 65,6% të bazes pensionale për femer.

Neni 89

(1) Punetoreve nga nenet 77, 82, 84 dhe 86 të ketij ligji që do të realizojne të drejte të pensionit të pleqerise sipas kushteve të pergjithshme kufiri i moshes për realizimin e të drejtes së pensionit të pleqerise u zvogelohet për nga një vit për çdo kater vite të mbaruara të kaluara efektive në vendet e punes ku stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar.

(2) Zvogelimi i kufirit të moshes ka të beje edhe me të siguruarit të cileve cilesia e të punesuarit nga nenet 77, 82, 84 dhe 86 të ketij ligji u ka perfunduar pa realizimin e të drejtes së pensionit të pleqerise sipas kushteve të vecanta të ketij ligji.

Neni 90

Vendet e punes nga nenet 82, 83 dhe 86 të ketij ligji për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur, si dhe vellimi i zvogelimit perkates të kufirit të moshes i nenshtrohen revizionit, në menyre dhe procedure me të cilat kryhet percaktimi i atyre vendeve të punes. Revizioni kryhet më së voni në afat prej pese vitesh nga dita e percaktimit të atyre vendeve të punes.

Neni 91

Dallimi ndermjet pensionit të percaktuar pa zbatimin e neneve prej 82 deri 89 të ketij ligji dhe pensionit të percaktuar me zbatimin e ketyre neneve, si dhe tere shuma e pensionit e percaktuar për të siguruarin që nuk i ka plotesuar kushtet e pergjithshme për realizimin e të drejtes së pensionit pa zbatimin e ketyre neneve, sigurohet nga Buxheti i Republikes së Maqedonise.

Kreu VIII

Fitimi dhe realizimi i të drejtave të personave të perndjekur dhe të burgosur për idete e veteqenies së popullit maqedonas dhe të shtetesise së tij

Neni 92

Të drejta për sigurim pensional dhe invalidor në kushte të vecanta ka edhe personi i perndjekur dhe i burgosur për idete e veteqenies së popullit maqedonas dhe shtetesise së tij.

Neni 93

(1) Cilesine e personit të perndjekur dhe të burgosur për idete e veteqenies së popullit maqedonas dhe shtetesise së tij me aktvendim e percakton komisioni i vecante i Qeverise së Republikes së Maqedonise, në baze të vendimit të organit kompetent.

(2) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni mund të parashtrohet ankese te Qeveria e Republikes së Maqedonise.

Neni 94

Personit nga neni 93 i ketij ligji koha e perndjekjes, perkatesisht koha e kaluar në vuajtjen e denimit me burg i njihet në stazhin pensional në kohezgjatje efektive.

Neni 95

Personi nga neni 93 i ketij ligji dhe anetaret e familjes së tij të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor i realizojne në kushtet e njejta si edhe të siguruarit tjere, nese me kete ligj nuk eshte percaktuar ndryshe.

Neni 96

Personit nga neni 93 i ketij ligji, pensioni i percaktohet nga baza pensionale që paraqet rroge mesatare të realizuar në Republike në vitin e fundit para vitit në të cilin realizohet pensioni i rritur për 30% ose nga baza pensionale, si edhe për të siguruarit tjere, nese kjo për atë eshte më e favorshme.

Neni 97

Personi nga neni 93 i ketij ligji kerkesen për pranim në stazh pensional të kohes së perndjekjes dhe kohes së kaluar në vuajtjen e denimit me burg, e dorezon në sherbimin profesional të Fondit.

Neni 98

Mjetet për njohjen e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor në kushte më të favorshme të personave nga neni 93 i këtij ligji, i siguron Buxheti i Republikës së Maqedonisë për:

- 1) shumën e plote të pensionit nëse i siguruari i plotëson kushtet për pension me stazhin nga neni 94 i këtij ligji;
- 2) dallimin ndërmjet pensionit të percaktuar me stazhin nga neni 94 i këtij ligji dhe pensionin e percaktuar pa atë stazh në rastet kur i siguruari i ka plotësuar kushtet për pension dhe
- 3) dallimin ndërmjet pensionit të percaktuar nga baza pensionale, si edhe për siguruesit e tjere dhe pensionin e percaktuar nga baza pensionale nga neni 96 i këtij ligji.

Kreu IX

Stazhi pensional

Neni 99

Në stazh pensional sipas këtij ligji në baze të të cilit fitohen dhe realizohen të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor, llogariten:

- 1) koha e kaluar në sigurim që sipas dispozitave të këtij ligji llogaritet në stazhin e sigurimit dhe
- 2) koha e kaluar në sigurim deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji që sipas rregullave në fuqi deri në atë ditë, është percaktuar në stazh pensional.

Stazhi i sigurimit që llogaritet në kohezgjatje efektive

Neni 100

Në stazhin e sigurimit llogaritet koha që i siguruari nga nenet 11, 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, pas mbushjes së 15 viteve në moshën e ka kaluar në marrëdhënie pune, perkatesisht në punë në baze të së cilës ka qenë i siguruar detyrimisht dhe nëse është paguar kontributi për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 101

(1) Në stazhin e sigurimit llogaritet koha e kaluar në marrëdhënie pune me orar të plote të punës.

(2) Me kohë të kaluar në marrëdhënie pune me orar të plote të punës, nenkuptohet dhe koha që në marrëdhënie pune me kohë shkurtuar të punës do ta kalojnë:

- 1) invaliditetin e punës, invaliditetin e luftës, invaliditetin civil të luftës, si dhe persona të tjere invalide, nëse ata punojnë për atë kohë që korrespondon me aftësitë e tyre të punës dhe
- 2) punetoret për gjidhënie apo kurim të fëmijës, perkatesisht punetoret për kurim të fëmijës.
- (3) Në stazhin e sigurimit llogaritet dhe koha e kaluar në marrëdhënie pune me orar të shkurtuar të punës, me përjashtim të rasteve nga paragrafi (2) i këtij neni, në kohezgjatje që korrespondon me numrin e përgjithshëm të orëve të punës së tilla të realizuar për vite të vecanta, të llogaritura për orar të plote të punës.

(4) Dispozitat e paragrafeve (1), (2) dhe (3) të këtij neni zbatohen dhe kur orari i punës është realizuar me punë në dy ose më shumë marrëdhënie pune.

Neni 102

(1) Në stazhin e sigurimit llogaritet dhe koha që i siguruari e ka kaluar:

- 1) në pushim mjekësor pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës ose në punë tjetër në baze të cilës ishte i siguruar, nëse për atë kohë ka marrë kompensim të rrogës dhe

2) në rehabilitim profesional perkatesisht rikualifikim ose kualifikim shtese ku eshte derguar si invalid i punes, ose si invalid i luftes, si i verber, person i semure me distrofi muskulore dhe semundjeve të lidhura neuromuskulare, nga paraplegjia, paraliza cerebrale dhe paraliza e femijeve dhe multipleks skleroza apo si invalid civil i luftes, pavaresisht nga fakti nese para kesaj ka qene i siguruar.

(2) Në stazhin e sigurimit llogaritet koha për të cilën i siguruari e shfrytëzon të drejtën e kompensimit të rrogës për orar të shkurtuar të punës, për shkak të kurimit të femijes me hendikep të rëndë sipas Ligjit për mbrojtje sociale.

Neni 103

Në stazhin e sigurimit llogaritet dhe koha që gjatë kohezgjatjes së marrëdhënies së punës i siguruari do ta kalojë në persosje profesionale apo specializim.

Neni 104

(1) Në stazhin e sigurimit llogaritet edhe koha që i siguruari gjatë kohezgjatjes së punës në baze të të cilit është siguruar, e ka kaluar:

- 1) në burg hetues deri në 30 dite;
- 2) në vuajtjen e dënimit me burg deri në 30 dite dhe
- 3) si pjesëmarrës në greve të organizuar në pajtim me rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Në stazhin e sigurimit të siguarit i llogaritet tere koha e kaluar në pezullim, ndërsa koha e kaluar në burg hetues nese me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është liruar nga përgjegjësia, aktakuza është refuzuar ose procedura është ndërprerë, por jo nga jokompetenca e gjykatës.

Neni 105

(1) Në stazhin e sigurimit llogaritet dhe koha e kaluar jashtë marrëdhënies së punës që invalidet e punës e kalojnë në pritje ose kryerje të rehabilitimit profesional, perkatesisht rikualifikimi ose kualifikim shtese si dhe pritje të punësimit perkates.

- (2) Koha e pritjes për dërgim për rehabilitimin profesional është gjashtë muaj.
- (3) Koha e pritjes për punësim perkates është më së shumti tre vite.

Neni 106

Në stazhin e sigurimit llogaritet koha e kaluar në sigurimin e detyrueshem me kusht që të jete paguar kontributi për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 107

Në stazhin e sigurimit llogaritet edhe koha e kaluar pas ndërprerjes së sigurimit të detyrueshem për të cilin është paguar kontributi - sigurim i vazhduar.

Stazhi i sigurimit që llogaritet me kohezgjatje të rritur

Neni 108

Të siguarve që punojnë pune vecanerisht të rënda dhe të rrezikshme për shëndetin, si dhe të siguarve që punojnë në vendet e punës në të cilat pas plotësimit të viteve të caktuara të jetës nuk mund ta kryejnë me sukses veprimtarinë e tyre profesionale, stazhi i sigurimit u llogaritet me kohezgjatje të rritur. Shkalla e rritjes së stazhit të sigurimit varet nga shkalla e rrezikut të punës, perkatesisht e natyrës së punës, në mënyrë që vendet e punës sistemohen në gjashtë grupe, me atë që çdo 12 muaj pune efektive, llogariten si 14, 15, 16, 17, perkatesisht 18 muaj stazh të sigurimit.

Neni 109

(1) Si vende të punes në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur, sepse puna në to është vecanerisht e veshtire dhe e demshme për shendetin, mund të percaktohen vendet e punes në të cilat jane plotesuar kushtet si vijojne:

1) në lidhje me kryerjen e puneve në vendet e punes të ekzistojne ndikime të konsiderueshme të demshme për shendetin dhe aftesine e punes së punetoreve, krahas asaj që jane zbatuar të gjitha masat e pergjithshme dhe të vecanta mbrojtese të percaktuara me rregulla, si dhe masat tjera që mund të ndikojne në menjanimin dhe zvogelimin e ndikimeve të demshme;

2) punet në vendet e punes në kushte të veshtira dhe të demshme shendetesore të kryhen drejtperdrejt, afer burimeve të ndikimeve të demshme gjate punes së pandërprere dhe

3) punet në vendet e punes në rrethanat e permendura në pikat 1 dhe 2 të ketij paragrafi t'i kryeje punetori i njejte gjate orarit të plote të punes, duke e marre si orar të plote të punes dhe kohen e punes më të shkurter se 40 orë në jave, të percaktuar për vende të vecanta të punes për shkak të kushteve të vecanta për pune.

(2) Si vende të punes në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur, sepse karriera e kryerjes së veprimtarise profesionale është e kufizuar me arritjen e moshes së caktuar, mund të percaktohen vendet e punes në ato profesione në të cilat për shkak natyres dhe peshes së punes, funksionet fiziologjike të organizmit bien në atë mase që punetorit ia pamundesojne kryerjen e metejme me sukses të veprimtarise së njejte profesionale.

Neni 110

Vendet e punes ku stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar sepse puna në to është vecanerisht e veshtire dhe e rrezikshme për shendetin, jane të percaktuara me rregullore që e miraton ministri i Punes dhe Politikes Sociale.

Neni 111

(1) Vendet e punes në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar e të cilat nuk jane perfshire me rregullore nga neni 110 i ketij ligji, menyren e percaktimit të tyre, shkallen e rritjes së stazhit të sigurimit të atyre vendeve të punes, i percakton Komisioni për Revizion të Vendeve të Punes në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar.

(2) Komisionin nga paragrafi (1) i ketij neni e formon ministri i Punes dhe Politikes Sociale në perberje prej tre anetareve, nga të cilet dy anetare persona profesionale dhe kompetente nga sfera e sigurise dhe shendetit gjate punes dhe një anetar nga sfera e sigurimit pensional dhe invalidor. Me akt të ministrit të Punes dhe Politikes Sociale rregullohet organizimi dhe menyra e punes së Komisionit për Revizion.

(3) Vendet e punes në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar nga paragrafi (1) i ketij neni, percaktohet pas mendimit paraprak të marre nga organizata perkatese profesionale, me iniciative të punedhenesve.

(4) Vendet e punes në të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar nga paragrafi (1) i ketij neni, i nenshtrohen revizionit që e kryen Komisioni për Revizion nga paragrafi (2) i ketij neni. Revizioni kryhet më së voni në afat prej pese vitesh nga dita e percaktimit të atyre vendeve të punes.

(5) Revizionit i nenshtrohen edhe vendet e punes të percaktuara sipas nenit 110 të ketij ligji.

(6) Për vendet e punes ku stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të shtuar, punedhenesi mund të inicioje procedure për ndryshimin e kushteve teknike dhe teknologjike të punes.

Neni 112

(1) Stazhi i sigurimit me kohezgjatje të shtuar u llogaritet edhe të siguruarve që në marredhenie pune, perkatesisht në pune në baze të së ciles kane qene të siguruar detyrueshem, kane kaluar duke punuar me orar të plote punes si të siguruar, me lendim trupor prej së paku 70

% (invalidë të luftës nga grupi I deri VI, invalidë civile të luftës nga grupi I deri VI, persona të verber, persona të semure me distrofi dhe semundje të ngjashme muskulore dhe neuromuskulore dhe nga paraplegjia, paraliza cerebrale dhe paraliza e femijeve dhe nga multipleks skleroza.

(2) Të siguruarve nga paragrafi (1) i këtij neni, çdo 12 muaj efektive të kaluar në marrëdhënie pune në baze të ciles janë të siguruar, u llogariten si 15 muaj stazh sigurimi, ndërsa kufiri i moshës i percaktuar për marrje të pensionit të pleqerisë nga neni 19, u zvogelohet për një vit në çdo pesë vjet efektive të kaluar në pune të tilla.

Neni 113

(1) Të siguruarve nga neni 102 paragrafi (2) të këtij ligji, që punojnë në vendet e punës ku stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur, stazhi i sigurimit u rritet vetëm për atë kohë që në mënyrë efektive e kanë kaluar në pune.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, të siguruarve që stazhi i sigurimit u llogaritet me kohezgjatje të rritur nga neni 112 i këtij ligji, ai stazh u rritet dhe nëse kanë punuar me orar të shkurtuar të punës, si të këne punuar me orar të plot të punës.

Neni 114

Në stazhin e sigurimit me kohezgjatje të rritur llogaritet dhe koha për të cilën të siguruarit kanë qenë të siguruar në sigurim pensional dhe invalidor në cilësinë e të siguruarit ushtarak ose personit civil në shërbim në Armatën Popullore të Jugosllavisë, përveç kohës që personi civil në shërbim në Armatën Popullore të Jugosllavisë e ka kaluar në trupe dhe atë në kushte dhe vëllim të percaktuara me rregullat me të cilat është rregulluar sigurimi pensional dhe invalidor i të siguruarve ushtarake.

Kreu X

Fondi solidar- ndihma pas vdekjes dhe taksa e anetaresisë

Neni 115

(1) Shfrytëzuesit të pensionit, me pelqimin e tij, i hiqet një pjesë e pensionit për sigurimin e mjeteve të nevojshme për pagesë të ndihmës pas vdekjes për anetaret e familjes së tij dhe për anetaresim në shoqatën e pensionistëve (taksa e anetaresisë).

(2) Mjetet për fondin solidar – ndihme pas vdekjes, Fondi i paguan në llogarinë e vecantë në kuader të llogarisë së thesarit me shenjë “Mjete për fondin solidar-ndihme pas vdekjes të shfrytëzuesve të pensionit”.

Neni 116

(1) Ndarja e ndihmës pas vdekjes dhe takses së anetaresisë, kryhet nga pensioni i shfrytëzuesit të pensionit, në nivel mujor, gjatë pagesës së pensionit, përveç pensionit familjar të femijes të realizuar në baze të shkollimit.

(2) Lartësia e heqjes për ndihme pas vdekjes dhe takses së anetaresisë, shumën e pagesës për ndihme pas vdekjes varesisht nga mjetet e akumuluarat dhe vdekshmeria e shfrytëzuesve të pensionit, mënyrën e ndarjes së takses së anetaresisë, mënyrën dhe procedurën për ndihme pas vdekjes të shfrytëzuesve të pensionit nga mjetet e fondit solidar në shumë unike për të gjithë shfrytëzuesit e pensionit, si dhe mënyrën e disponimit me mjetet e lira dhe të paperdorura të ndihmës pas vdekjes, me akt i percakton organizata e regjistruar e lidhjeve të shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë.

(3) Akti nga paragrafi (2) i këtij neni shpallet në fillim të çdo viti në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Mjetet në baze të takses së anetaresisë, Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë i dërgon në llogarinë që e percakton organizata e regjistruar nga lidhjet e shoqatave të pensionistëve.

Neni 117

Pagesen e ndihmes pas vdekjes nga fondi solidar, e kryen sherbimi profesional i Fondit nepermjet njesive rajonale.

Kreu XI

Sigurimi i detyrueshem pensional me financim kapital

Neni 118

(1) Të siguruarit nga neni 11 me perjashtim të pikes 9 dhe neneve 12 dhe 13 të ketij ligji, që për here të pare në sigurimin e detyrueshem pensional me financim kapital kane hyre nga 1 janari 2003, jane anetare të detyrueshem të shtyllës së dyte pensionale. Të siguruarit nga Kapitulli VII - Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguruarve në kushte të vecanta, nuk perfshihen në shtyllën e dyte pensionale.

(2) Të siguruarit nga paragrafi (1) i ketij neni për shkak të ndryshimit të cilesise së të siguruarit, me zgjedhje personale, mundet vetem një here ta revokojë statusin e percaktuar. Kete të drejte i siguruari mund ta realizojë më së voni në afat prej një viti nga ndryshimi i kryer.

Neni 119

(1) Të siguruarit nga neni 11, me perjashtim të pikes 9 dhe neneve 12 dhe 13 të ketij ligji, që jane perfshire në sigurimin e detyrueshem pensional dhe invalidor deri më 1 janar 2003, me zgjedhje personale mund të perfshihen në shtyllën e dyte pensionale, pervec të siguruarve nga Kapitullit VII - Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguruarve në kushte të vecanta.

(2) Të siguruarit nga paragrafi (1) i ketij neni nuk mund ta revokojnë zgjedhjen personale.

Neni 120

(1) Shkalla e kontributit për shtyllën e dyte pensionale eshte 6% nga baza për pagese të kontributit të percaktuar me ligj.

(2) Shkalla e kontributit për shtyllën e pare pensionale paraqet dallim ndermjet shkallës së pergjithshme të kontributit nga shtylla e pare dhe perqindjes nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Për të siguruarit për të cilet kontributi për sigurim pensional dhe invalidor llogaritet dhe paguhet në neto, ndersa ndarja e kontributeve kryhet në perpjesetim të njejte sipas paragrafeve (1) dhe (2) të ketij neni.

Neni 121

(1) I siguruari që paguan kontribut për shtyllën e dyte pensionale ka llogari individuale dhe eshte anetar i fondit të detyrueshem pensional.

(2) Pensioni nga shtylla e dyte pensionale varet nga kontributet e akumuluar dhe të ardhurat e realizuara nga kontributet e investuara të akumuluar pas heqjes së shpenzimeve.

(3) Pas realizimit të së drejtes për pension të pleqerise në shtyllën e pare pensionale, mjetet e të siguruarit nga llogaria individuale transferohen në institucion të vecante të autorizuar për pagesen e pensioneve.

(4) Themelimi dhe funksionimi i institucioneve nga paragrafi (3) i ketij neni, rregullohet me Ligjin për pagese të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital.

Neni 122

(1) Kur i siguruari e realizon të drejten për pension invalidor ose pension familjar në shtyllën e pare pensionale, fondi i detyrueshem pensional ia bart kontributet e akumuluar dhe të ardhurat e realizuara Fondit për pagesen pensionit invalidor, perkatesisht pensionit familjar.

(2) Procedura për pagesen e pensionit invalidor perkatesisht pensionit familjar të të siguarit në shtyllen e dyte pensionale që e ka realizuar të drejten për pension invalidor perkatesisht pension familjar, rregullohen me Ligjin për pagese të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital.

(3) Me Ligjin nga paragrafi (2) i ketij neni rregullohen edhe detyrimet e Fondit për sigurim të pensionit minimal nga shtylla e dyte pensionale.

Neni 123

Nese nuk ekzistojne shfrytezues të pensionit familjar, shuma nga llogaria individuale e të siguarit paguhet në menyre të njejte si edhe prona tjetere në pajtim me Ligjin për trashëgimi.

Neni 124

Evidencen e të dhenave për të siguarit në shtyllen e dyte pensionale dhe për ndarjen e kontributit të pergjithshem për shtyllen e pare dhe të dyte të sistemit pensional, e udheheq Fondi.

Kreu XII

Realizimi, shfrytezimi dhe humbja e të drejtave

1. Realizimi i të drejtave

Neni 125

(1) Të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor realizohen në Fond.

(2) Fondi eshte kompetent edhe kur të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor realizohen në baze të marreveshjeve të ratifikuara nderkombetare.

(3) Të drejten e sigurimit pensional dhe invalidor mund ta realizoje personi, që ka cilesi të të siguarit sipas ketij ligji.

(4) Cilesia e të siguarit vendoset në baze të kerkeses për sigurim që e parashtron:

1) punedhenesi - për punetoret e punesuar te ai;

2) personi fizik që kryen veprimtari – për vetveten;

3) bujku individual - për vetveten;

4) Agjencia për Punesim e Republikes së Maqedonise për persona të papunesuar që marrin kompensim në para, ose jane në trajnim profesional perkatesisht rehabilitim profesional;

5) detyresi për pagese të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor - për personat nga neni 11 paragrafi (1) pikat 12 dhe 13 dhe nenet 15 dhe 16 të ketij ligji dhe

6) i siguarit nga neni 12 i ketij ligji – për vetveten.

(5) Nese personat nga paragrafi (2) pikat 2 dhe 3 të ketij neni nuk parashtrojne kerkese, cilesine e të siguarit e percakton Fondi me detyre zyrtare. Cilesia e të siguarit fitohet nga dita e regjistrimit të veprimtarise në regjistrin perkates, perkatesisht nga dita e caktuar për fillimin e kryerjes së veprimtarise.

Neni 126

(1) Procedura për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor ngritet me kerkese të të siguarit, perkatesisht shfrytezuesit të pensionit, ndersa për realizimin e të drejtes së pensionit familjar dhe të drejtave të tjera të anetareve të familjes së të siguarit, perkatesisht të shfrytezuesit të pensionit, me kerkese të anetarit të familjes.

(2) Procedura për percaktimin e invaliditetit te i siguarit ngritet edhe me propozim të punedhenesit te i cili i siguarit eshte në marredhenie pune, si dhe me propozim të mjekut amë kompetent dhe prej komisionit mjekesor të Fondit për Sigurim Shendetesor të Maqedonise.

(3) Me kerkese, perkatesisht propozim për percaktimin e invaliditetit perkatesisht paaftesise për pune, parashtruesi eshte i detyruar të paraqese dokumentacion mjekesor, të punes dhe tjetere, si dhe propozimin e komisionit mjekesor të Fondit për Sigurim Shendetesor, të nevojshem për percaktimin e invaliditetit.

(4) Procedura për percaktimin e invaliditetit, perkatesisht paaftesise për pune ngritet perseri, pas kalimit të afatit prej një viti nga dita e kontrollit nga komisioni i Fondit. Kjo procedure mund të ngritet dhe përpara kalimit të ketij afati, nese me kerkese eshte dorezuar dokumentacion i ri mjekesor për ndryshimin, perkatesisht perkeqesimin e ndodhur të shendetit.

(5) I siguruari eshte i detyruar të marre pjese në procedure që eshte ngritur sipas paragrafit (2) të ketij neni.

(6) Fondi me akt të pergjithshem e rregullon dokumentacionin e detyrueshem mjekesor të nevojshem për percaktimin e invaliditetit.

Neni 127

(1) Kerkesa për realizimin e të drejtes së sigurimit pensional dhe invalidor parashtrohet në filialet dhe deget e Fondit, sipas vendit të sigurimit të fundit.

(2) Në procedure për zgjidhjen e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor do të zbatohen rregullat për procedure të pergjithshme administrative.

(3) Fondi me Statut, në pajtim me dispozitat e ketij ligji, nga afersisht e rregullon menyren e realizimit të të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor.

Neni 128

(1) Ndryshimet e gjendjes së invaliditetit dhe demtimeve trupore të të siguarit, që ndikojne në të drejten e pranuar me aktvendim të plotfuqishem, mund të percaktohen në proceduren e ngritur me kerkese të të siguarit.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, organi kompetent për zgjidhjen e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, mundet me iniciativen e mjekut individual, komisionit për vleresimin e aftesise për pune, punedhenesit ose të Fondit, mund të caktoje kontroll të serishem me komision të invalideve të punes me aftesine e mbetur të punes që mbi kete baze kane marre ndonje të drejte për percaktimin e ndryshimeve në gjendjen e invaliditetit, perkatesisht për percaktimin e nevojes dhe mundesise për shfrytezim më të pershtatshem të aftesise së mbetur për pune.

Neni 129

(1) Stazhi pensional, rroga, kompensimet dhe bazat e sigurimit, si dhe fakte tjera me ndikim në marrjen dhe percaktimin e të drejtave merren parasysh gjate realizimit të të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, në baze të të dhenave të percaktuara në evidencen amë.

(2) Faktet që në pajtim me kete ligj nuk percaktohen në evidencen amë, e jane me ndikim për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, percaktohen në procedure për zgjidhjen e ketyre të drejtave.

(3) Stazhi pensional nuk mund të percaktohet në baze të deklarates së deshmitareve.

Neni 130

(1) Për realizimin e të drejtave në baze të invaliditetit dhe paaftesise për pune mbi bazen e të cilave fitohet e drejta e invaliditetit, perkatesisht pensionit familjar si dhe demtimet trupor, gjendja faktike percaktohet në baze të konstatimit, vleresimit dhe mendimit të Komisionit për Vleresimin e Aftesise për Pune. Komisioni formohet në kuader të Fondit.

(2) Me akt të Fondit rregullohet organizimi, perberja dhe menyra e punes së Komisionit për Vleresimin e Aftesise për Pune.

(3) Në konstatimin, vleresimin dhe mendimin në baze të të cilave percaktohet invaliditeti, perkatesisht paaftesia për pune në baze të së ciles fitohet e drejta e invaliditetit, perkatesisht pensionit familjar, percaktohet edhe obligimi për kontroll të detyrueshem që kryhet në afat jo më të shkurter se një vit nga dita e percaktimit të invaliditetit. Kontrolli mund të kryhet më së shumti dy here deri në mbushjen e 65 vjeteve të shfrytezuesit të pensionit. Kontrollit të detyrueshem nuk i nenshtrohet shfrytezuesi i pensionit për semundje të caktuara të percaktuara me aktin për organizim, perberjen dhe menyren e punes së Komisionit për Vleresimin e Aftesise për Pune.

(4) Kontrollin e detyrueshem nga paragrafi (3) i ketij neni e kryen Komisioni për kontroll të detyrueshem i perbere nga mjeket specialiste në organ, perkatesisht institucion të percaktuar nga ministri i Punes dhe Politikes Sociale.

(5) Kontrollin e detyrueshem nga paragrafi (4) i ketij neni nuk mund ta kryejne personat e njejte, të cilet më pare kane marre pjese në procedure për percaktimin e invaliditetit.

(6) Deri në miratimin e aktvendimit për kryerje të kontrollit të detyrueshem, të siguruarit i paguhet pension i perkohshem invalidor, perkatesisht pension familjar.

(7) E drejta e pensionit invalidor, perkatesisht familjar nderpritet nese shfrytezuesi nuk paraqitet në kontroll të detyrueshem në afatin e percaktuar në paragrafin (3) të ketij neni, ose me kontroll nuk eshte percaktuar invaliditet, perkatesisht paaftesi për pune.

(8) Në rastet e percaktuara në paragrafin (7) të ketij neni shfrytezuesit me aktvendim perkohesisht i nderpritet pagesa e pensionit invalidor, perkatesisht pensionit familjar dhe e humb cilesine e pensionistit.

Neni 131

(1) Konstatimi, vleresimi dhe mendimi i Komisionit për vleresim të aftesise për pune, me të cilat eshte percaktuar invaliditeti, perkatesisht paaftesia për pune, në baze të të cilave fitohet e drejta e pensionit, si dhe konstatimi i Komisionit për kontroll të detyrueshem, detyrimisht i nenshtrohen revizionit. Revizionin e kryen Komisioni për revizion të konstatimit, vleresimit dhe mendimit për percaktim të invaliditetit, perkatesisht paaftesise për pune, të cilin e formon ministri i Punes dhe Politikes Sociale, nga ekspertet e shquar të mjekesise.

(2) Komisioni për revizion të konstatimit, vleresimit dhe mendimit për percaktim të invaliditetit, perkatesisht paaftesise për pune, kryen revizion edhe të konstatimit, vleresimit dhe mendimit me të cilat nuk eshte percaktuar invaliditet, perkatesisht paaftesi për pune, të miratuara nga Komisioni për Vleresim të Aftesise për Pune, me zgjedhje të rastit.

(3) Gjate kryerjes së revizionit mund të kryhet kontroll i drejtperdrejte mjekesor i të siguruarit.

(4) Revizioni nga paragrafi (1) i ketij neni kryhet më së voni në afat prej pese ditesh nga dita e miratimit të konstatimit, vleresimit dhe mendimit, para miratimit të aktvendimit për të drejte për pension.

(5) Komisioni për Vleresim të Aftesise për Pune dhe Komisioni për Kontroll të Detyrueshem, detyrohen që të veprojne sipas mendimit të dhene në proceduren për revizion dhe të miratojne konstatim, vleresim dhe mendim të ri.

(6) Me akt të ministrit të Punes dhe Politikes Sociale rregullohet organizimi, perberja dhe menyra e punes së Komisionit për Revizion.

Neni 132

(1) Aktvendim për të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe për arketimin e kontributit miraton Fondi, më së voni në afat prej 60 ditesh nga dita e parashtrimit të kerkeses së rregullt.

(2) Në rastet kur miratimit të aktvendimit i paraprin percaktim i gjendjes faktike sipas nenit 130 të ketij ligji, Fondi eshte i detyruar që të miratoje aktvendim më së voni në afat prej 50 ditesh nga dita e parashtrimit të kerkeses.

(3) Në aktvendimin me të cilin percaktohet invaliditet, perkatesisht paaftesi për pune, caktohet edhe dita kur i siguruari, perkatesisht shfrytezuesi i së drejtes, duhet të paraqitet në kontroll të detyrueshem në pajtim me nenin 130 paragrafi (3) të ketij ligji.

Neni 133

(1) Nese Fondi nuk miraton aktvendim për realizimin e së drejtes për sigurim pensional dhe invalidor, perkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kerkeses në afatin e percaktuar me nenin 132 paragrafi (1) të ketij ligji ose nuk miraton vertetim për të dhenat e futura në evidencen

amë, perkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kerkeses në afatin e percaktuar me nenin 207 paragrafet (1) dhe (4) të ketij ligji, parashtruesi i kerkeses ka të drejte që në afat prej tri diteve të punes nga kalimi i atij afati, të parashtroje kerkeses në sekretarine e drejtorit të Fondit, për mosmiratim të aktvendimit për kerkesen e parashtruar.

(2) Formen dhe permbajtjen e formularit të kerkeses nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri i Punes dhe Politikes Sociale.

(3) Drejtori i Fondit eshte i obliguar që në afat prej pese diteve të punes nga dita e parashtrimit të kerkeses nga paragrafi (1) i ketij neni, të miratoje aktvendim me të cilin kerkesen do ta pranoje ose refuzoje.

(4) Nese drejtori i Fondit nuk ka sekretari, kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Fondit.

(5) Me kerkesen për realizimin e së drejtes për sigurim pensional dhe invalidor, perkatesisht me kerkesen për vertetim për të dhenat e futura në evidencen amë, parashtruesi i kerkeses dorezon edhe kopje të kerkeses nga nenet 126 dhe 207 të ketij ligji.

(6) Nese drejtori i Fondit nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (3) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ në afat prej pese diteve të punes.

(7) Inspektorati Shteteror Administrativ eshte i obliguar që në afat prej dhjete ditesh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (6) i ketij neni, të kryeje mbikeqyrje inspektuese te Fondi dhe të konstatoje nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer inspektuese, ta informoje parashtruesin e kerkeses.

(8) Inspektori i Inspektoratit Shteteror Administrativ pas mbikeqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon drejtorin e Fondit që në afat prej dhjete ditesh të vendose për kerkesen e parashtruar, perkatesisht ta pranoje ose refuzoje kerkesen dhe për masat e ndermarra ta njoftoje Inspektoratin Shteteror Administrativ dhe t'i dorezoje ekzemplar nga akti me të cilin eshte vendosur për kerkesen.

(9) Nese drejtori i Fondit nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i ketij neni, inspektori do të parashtroje kerkese për ngritjen e procedures për kundervajtje dhe do të caktoje afat plotesues prej pese diteve të punes, në të cilat drejtori do të vendose për kerkesen e parashtruar për cfare në afatin e njejte do ta njoftoje inspektorin për afatin e miratuar. Me njoftim dorezohet edhe kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kerkesen e parashtruar. Inspektori në afat prej tri diteve të punes e informon parashtruesin e kerkeses. Inspektorati Shteteror administrativ do të paraqese kallezim deri tek prokurori publik kompetent.

(10) Nese drejtori nuk vendos as në afatin plotesues nga paragrafi (9) i ketij neni, inspektori në afat prej tri diteve të punes do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informoje parashtruesin e kerkeses për masat e ndermarra.

(11) Nese inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (7) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses në afat prej pese diteve të punes ka të drejte të parashtroje kundershtrim në sekretarine e drejtorit të Inspektoratit Shteteror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari kerkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Inspektoratit Shteteror Administrativ.

(12) Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ eshte i detyruar që në afat prej tri diteve të punes nga dita e pranimit, ta shqyrtoje kundershtrimin nga paragrafi (11) i ketij neni, dhe nese konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kerkeses nga paragrafi (7) i ketij neni ose nuk paraqet kallezim në pajtim me paragrafin (10) të ketij neni, Drejtori i Inspektoratit shteteror administrativ do të paraqese kerkese për ngritjen e procedures për kundervajtje për inspektorin, dhe do të caktoje afat plotesues prej pese diteve të punes, në të cilat inspektori do të kryeje mbikeqyrje në Fond nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informoje parashtruesin e kerkeses.

(13) Nese inspektori nuk vepron në afatin plotesues nga paragrafi (12) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent kunder inspektorit, dhe në afat prej tri diteve të punes do ta informoje parashtruesin e kerkeses.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ, menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikeqyrjen menjehere.

(15) Në rastet nga paragrafi (14) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ, në afat prej tri diteve të punes e informon parashtruesin e kerkeses.

(16) Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (12) të ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të paraqese kallezim te prokurori publik kompetent në afat prej tri diteve.

(17) Nese drejtori i Fondit nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i ketij neni, parashtruesi i kerkeses mund të ngrite kontest administrativ para gjykates kompetente.

(18) Procedura para Gjykates administrative është urgjente.

(19) Pas shpalljes së aktit nenligjor nga paragrafi (2) i ketij neni në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise", ai publikohet në ueb faqen e Ministrise së Punes dhe Politikes Sociale.

Neni 134

(1) Kunder aktvendimit të miratuar në shkalle të pare të Fondit, parashtruesi i kerkeses ka të drejte ankese në Komisionin shteteror për vendimmarrje në procedure administrative dhe procedure të marredhenies së punes në shkalle të dyte, në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(2) Ankesa nga paragrafi (1) i ketij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit, pervec nese me ankese kundershtohet vleresimi për percaktim të invaliditetit.

Neni 135

Kunder aktvendimit të Komisionit shteteror për vendimmarrje në procedure administrative dhe procedure nga marredhenia e punes në shkalle të dyte nga neni 134 i ketij ligji, mund të ngritet kontest administrativ.

Neni 136

(1) Nese pas miratimit të aktvendimit perfundimtar njoftohet për fakte të reja, ose gjenden, perkatesisht fitohet mundesia të perdoren deshmi të reja, që vet ose në lidhje me deshmitë tanime të paraqitura dhe të perdorura do të mund të rezultojne në aktvendim tjetër, nese ato fakte, perkatesisht deshmi do të paraqiteshin ose perdoreshin në proceduren paraprake, mundet me perjashtim të kushteve të cilat në raste të tilla sipas Ligjit për procedure të pergjithshme administrative kerkohen për ngritje - perteritje të procedures, të ngritet perteritje e procedures për të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor edhe kur është leshuar në proceduren paraprake të paraqitet ndonje prej atyre fakteve, perkatesisht deshmitë.

(2) Perteritja e procedures ngritet me kerkese të pales ose me detyre zyrtare.

(3) Perteritja e procedures në rastet nga paragrafi (1) i ketij neni, ngritet pa marre parasysh afatet që janë parapare në Ligjin për procedure të pergjithshme administrative për kerkese perteritje të procedures, perkatesisht ngritje të procedures së tille.

(4) Nese kerkesa për perteritje të procedures është paraqitur, perkatesisht procedura për perteritje është ngritur në afat prej pese vitesh nga dita e dorezimit të aktvendimit pales, në proceduren për perteritje zbatohen rregullat që kane qene në fuqi në kohen e miratimit të aktvendimit. Nese kerkesa është paraqitur, perkatesisht procedura për perteritje është ngritur pas kalimit të ketij afati, në proceduren për perteritje zbatohen rregullat që kane qene në fuqi në kohen e parashtrimin të kerkeses për perteritje të procedures, perkatesisht në kohen e ngritjes së asaj procedure.

(5) Në procedurën për vendimmarrje për kërkesat për perteritje të procedurës për percaktimin e stazhit pensional zbatohen dispozitat e Ligjit për procedure të pergjithshme administrative.

Neni 137

Të drejtat e percaktuara me aktvendim të miratuar në procedurën për perteritje sipas nenit 136 të këtij ligji, realizohen nga dita e pare e muajit të ardhshem nga dita e paraqitjes së kërkeses për perteritje të procedurës, perkatesisht pas miratimit të aktvendimit në procedurën e perterire me detyre zyrtare.

Neni 138

(1) Aktvendimi i plotfuqishem, me kerkese së pales ose me detyre zyrtare, mund të ndryshohet me aktvendim të ri, nese me aktvendimin e plotfuqishem eshte shkelur ligji ose akti i pergjithshem i Fondit në dëm të pales.

(2) Nese me aktvendimin e plotfuqishem eshte shkelur ligji ose akti i pergjithshem i Fondit në dëm të pales, e drejta sipas aktvendimit të ri fillon nga dita kur jane permbushur kushtet për fitimin e së drejtes.

Neni 139

(1) Aktvendimi i plotfuqishem me të cilin të siguruarit i eshte njohur e drejta, që sipas rregullave nga sigurimi pensional dhe invalidor nuk i takon, me aktvendim të ri shpallet i pavlefshem, plotesisht ose pjeserisht.

(2) Me shpalljen e aktvendimit të pavlefshem, anulohen edhe pasojat juridike që i ka prodhuar aktvendimi i tille.

2. Shfrytezimi dhe humbja e të drejtave

Neni 140

(1) Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor të percaktuara me kete ligji, fitohen edhe arrijne me ditën e permbushjes së kushteve, nese kerkesa eshte paraqitur në afat prej gjashte muajsh nga dita e permbushjes së kushteve, e nese kerkesa eshte paraqitur pas kalimit të këtij afati, nga paraqitja e kërkeses edhe për gjashte muaj retroaktivisht.

(2) E drejta e pensionit sipas pleqerise realizohet pas nderprerjes së sigurimit.

(3) E drejta e pensionit invalidor në baze të aktvendimit për invaliditet të percaktuar, realizohet më së voni në afat prej tre muajsh nga plotfuqishmeria e aktvendimit.

(4) Nese e drejta e pensionit invalidor nuk realizohet në afatin e caktuar në paragrafin (3) të këtij neni, i siguruari dergohet në rikontroll te komisioni, me detyre zyrtare.

Neni 141

(1) Pensioni dhe kompensimet tjera në para percaktohen në shume mujore dhe paguhen retroaktivisht.

(2) Shfrytezuesi i pensionit ose i kompensimit në para mund të autorizojë person tjetër i cili në emer të tij do ta pranojë pensionin ose kompensimin në para.

(3) Me kerkese të Fondit, shfrytezuesi i pensionit ose kompensimit në para eshte i detyruar, që të dorezojë vertetim për jete të leshuar nga Fondi.

(4) Fondi i siguron shfrytezuesit pagese të shumave që i takojne sipas këtij ligji në rastet kur shfrytezuesi ka vendbanim jashte territorit të Republikës së Maqedonise me kushte të parapara me kete ligj, me marreveshje të ratifikuar nderkombetare ose nese ekziston reciprocitet.

Neni 142

E drejta e rehabilitimit profesional dhe kompensimet në para në lidhje me ato të drejta kufizohen, perkatesisht nderpriten nese në afat prej një muaji invalidi i punes nuk shkon në rehabilitim profesional, nese pa shkaqe të arsyeshme e nderpret rehabilitimin profesional ose nese nuk e kryen detyren në lidhje me rehabilitimin ose nese në afat të caktuar nuk i pergjigjet fteses për rivleresim të aftesise për pune.

Neni 143

Shfrytezuesit të pensionit dhe kompensimit në para për demtim trupor - shtetas i huaj, i cili do të shperngulet për jetese të perhershme në vendin shtetas i të cilit është, pensioni i paguhet jashte vendit nese me shtetin perkates është lidhur marreveshje e ratifikuar nderkombetare për pagesen e pensioneve jashte vendit, ose nese ekziston reciprocitet.

Neni 144

Shfrytezuesit të pensionit - shtetas i Republikës së Maqedonise i cili do të shperngulet në vend të huaj, pensioni dhe të ardhurat tjera në para i paguhet nese detyrimi i tille është parapare me marreveshje ndershtetore, perkatesisht marreveshje të ratifikuar nderkombetare.

Neni 145

Shuma më e ulet e pensionit, e fituar sipas ketij ligji, paguhet derisa shfrytezuesi i pensionit ka vendbanim të perhershëm në Republikën e Maqedonise, nese nuk është parapare ndryshe me marreveshje të ratifikuar nderkombetare.

Neni 146

Shfrytezuesve të pensionit të cileve nuk u behet pagesa e pensionit sipas neneve 143 dhe 144 të ketij ligji, nese vendosen serish në Republikën e Maqedonise, pagesa e pensionit u vazhdohet nga dita e pare e muajit të ardhshëm pas kthimit në Republikën e Maqedonise.

Neni 147

Shfrytezuesi i së drejtes së realizuar sipas ketij ligji është i obliguar ta paraqese çdo ndryshim që ndikon në të drejten ose në vëllimin e shfrytezimit të së drejtes, më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita kur ka ndodhur ndryshimi.

Neni 148

(1) Shfrytezuesit të pensionit, derisa është në marrëdhënie pune ose derisa ushtron veprimtari të pavarur në Republikën e Maqedonise ose jashte vendit, i nderpritet pagesa e pensionit.

(2) Shfrytezuesit të pensionit të pleqerise mund t'i caktohet shume e re e pensionit, nese ka mbushur së paku një vit stazh të sigurimit pas realizimit të së drejtes për pension të pleqerise, nese është më e volitshme për shfrytezuesin.

Neni 149

E drejta e pensionit familjar nderpritet për anëtarin e familjes te i cili për shkak të ndryshimit të ndodhur, tanime nuk ekzistojne kushtet e posacme prej të cilave varet marrja dhe kohezgjatja e asaj të drejte.

Neni 150

(1) Të drejtat e fituara në baze të invaliditetit dhe demtimit trupor gjate shfrytezimit, mund të ndryshohen varesisht nga ndryshimet e ndodhura të invaliditetit, perkatesisht shkalles së demtimit trupor.

(2) Kur ndryshimi nga paragrafi (1) i ketij neni është percaktuar me kerkese të shfrytezuesit të së drejtes, e drejta nderpritet ose ndryshohet, perkatesisht fitohet e drejte e re nga dita e pare e muajit të ardhshëm pas parashtrimit të kerkeses.

(3) Kur ndryshimi nga paragrafi (1) do të ndodhe në procedure të ngritur me detyre zyrtare, e drejta nderpritet ose ndryshohet, perkatesisht fitohet e drejte e re nga perfundimi i aktvendimit me të cilin është percaktuar ndryshimi.

Neni 151

(1) Nese i siguruari, perkatesisht shfrytezuesi i pensionit e fiton të drejten e dy ose më tepër pensioneve sipas këtij ligji, mund ta shfrytezojë vetëm njerin nga ato pensione me zgjedhje personale. Pas zgjedhjes së bere i siguruari nuk ka të drejtë rizgjedhjeje.

(2) Pensioni familjar shfrytezohe si një pension edhe kur u është caktuar më tepër shfrytezuesve nese bashkeshfrytezuesit nuk kërkojnë që pensioni t'u paguhet veç e veç.

Neni 152

(1) Pensioni mund të jete lende e permbarimit dhe sigurimit deri në një të treten, ndersa për kerkese në baze të mbajtjes të percaktuar me vendim gjyqësor ose me marreveshje deri në gjysme.

(2) Shuma më e ulet e pensionit dhe pensioni minimal i pleqerise dhe familjar nuk mund të jete lende e permbarimit dhe sigurimit, pervec për kerkese në baze të mbajtjes të percaktuar me vendim gjyqësor dhe pelqim të dhene nga shfrytezuesi i pensionit dhe atë më së shumti deri në një të treten nga shuma e tij mujore.

(3) Kompensimi në para për demtim trupor nuk mund të jete lende e permbarimit dhe sigurimit.

Neni 153

Shumat e arritura mujore të pensionit dhe të drejtat tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor që nuk kane mundur të paguhen për shkak të rrethanave që i ka shkaktuar shfrytezuesi i së drejtes, në menyre plotesuese do të paguhen më së shumti për tre vite retroaktivisht, duke llogaritur nga dita kur pas nderprerjes së veprimtimit të atyre rrethanave shfrytezuesi i së drejtes do të parashtrojë kerkese për pagese.

Kreu XIII

Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor

Neni 154

Fondi i kryen punet në vijim:

- 1) i zbaton rregullat dhe politikat e zhvillimit të sigurimit pensional dhe invalidor;
- 2) me akte të pergjithshme i rregullon ceshtjet për të cilat është i autorizuar me kete ligj;
- 3) i ndjek dhe analizon gjendjet në sigurimin pensional dhe invalidor;
- 4) kujdeset për realizimin e ligjshem të së drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe u jep ndihme profesionale të të siguruarve dhe shfrytezuesve të të drejtave për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre.
- 5) i zbaton marreveshjet e ratifikuara nderkombetare dhe marreveshjet ndershteterore për sigurim social në pjesen e sigurimin pensional dhe invalidor;
- 6) rregullisht e ndjek gjendjen e pageses së kontributit për sigurim pensional dhe invalidor;
- 7) merr masa për shfrytezim racional të mjeteve të nevojshme për sigurimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor;
- 8) vendos për të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor në shkalle të pare;
- 9) kryen pagese të pensioneve dhe kompensimeve në para në pajtim me ligjin;
- 10) kryen pagese të ndihmes në rast vdekjeje për shfrytezuesit e pensionit dhe zbritje nga pensioni për takse anetaresie dhe
- 11) kryen pune tjera të percaktuara me ligj, Statutin dhe aktet tjera të Fondit.

Neni 155

(1) Organet e Fondit jane Keshilli Drejtues dhe drejtori.

(2) Drejtori i Fondit ka zevendes.

Neni 156

(1) Fondin e menaxhon Keshilli Drejtues.

(2) Keshilli Drejtues ka shtate anetare të cilet i emerone Qeveria e Republikës së Maqedonisë në kohe zgjatje prej kater vitesh. Nga numri i pergjithshem i anetareve, pese anetare emerohen me propozim të:

- një perfaqesues i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale,
- një perfaqesues i Ministrisë së Financave,
- një perfaqesues i propozuar nga sindikata anetar i Keshillit Ekonomik Social,
- një perfaqesues nga shoqata reprezentative e punedhenesve anetar i Keshillit Social Ekonomik dhe
- një perfaqesues nga Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë.

(3) Keshilli Drejtues nga radhet e veta zgjedh kryetar dhe zevendes kryetar në kohe zgjatje prej një viti.

(4) Si anetare të Keshillit Drejtues propozohen persona që kane arsimim të larte dhe pervoje pune nga drejtësia, puna financiare ose nga sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor.

(5) Keshilli Drejtues i Fondit, së paku një here në vit parashtron raport për punen e vet për miratim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Neni 157

(1) Keshilli Drejtues i Fondit:

- 1) miraton Statut dhe akte tjera të Fondit në pajtim me kete ligj;
- 2) miraton program dhe plan për pune;
- 3) percakton propozim-kerkese buxhetore në Ministrinë e Financave;
- 4) miraton llogari perfundimtare të Fondit;
- 5) kujdeset për pagesen e rregullt të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor;
- 6) vendos për shfrytezimin e mjeteve të Fondit;
- 7) vendos për shitjen e pronës në pronësi të Fondit;
- 8) vendos për shitjen e pronës së dhene në shfrytezim të perhershëm të Fondit, me pelqim paraprak të Qeverisë;
- 9) miraton vendim për shitjen e aksioneve dhe pjesemarrjeve nga kapitali i pergjithshem i fituar në baze të transformimit të ndermarrjeve me kapital shoqeror;
- 10) kujdeset edhe e ndjek pagesen e ndihmes në rast vdekjeje shfrytezuesve të pensionit dhe të mjeteve të ndara nga pensionet për takse të anetaresise;
- 11) e ndjek realizimin e marreveshjeve të ratifikuara nderkombetare dhe marreveshjeve ndersteterore nga sfera e sigurimit pensional dhe invalidor;
- 12) shqyrton ceshtje, raporte, informata dhe materiale tjera lidhur me gjendjet dhe problemet nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe pune të tjera në kompetence të Fondit;
- 13) merr masa për sigurimin dhe funksionimin e sistemit informativ të Fondit;
- 14) shpall konkurs publik për emerim të drejtorit të Fondit;
- 15) themelon komisione trupa tjere punues dhe
- 16) vendos për pune tjera të percaktuara me ligj dhe Statutin e Fondit.

(2) Statutin dhe aktet tjera nga paragrafi (1) pika 1 e ketij neni, i miraton Keshilli Drejtues i Fondit, pas mendimit të marre paraprakisht nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Keshilli Drejtues i miraton vendimet me shumice votash nga numri i pergjithshem i anetareve.

Neni 158

Anetari i Keshillit Drejtues shkarkohet edhe para kalimit të afatit për të cilin eshte emeruar:

- me kerkese të tij,
- nese mungon nga mbledhjet e Keshillit Drejtues pa arsye së paku dy here të njepasnjeshme,
- nese i eshte nderprere baza në të cilën eshte propozuar,

- nese konstatohet në menyre plotesuese se ka personalisht, ose permes personit të trete ose në cfaredo baze interesa që mund të kene cfaredo qofte ndikimi në pavaresine dhe paanshmerine e tij dhe

- nese punon në kundërshtim me ligjin.

Neni 159

(1) Fondi ka drejtor dhe zëvendës drejtor, të cilët i emeron Këshilli Drejtues me konkurs publik.

(2) Konkursi nga paragrafi (1) i këtij neni shpallet së paku në dy gazeta ditore, prej të cilave në një nga gazetat që botohen në gjuhën maqedonase dhe në gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(3) Në konkurs përcaktohet kohezgjatja e konkursit, që nuk mund të jete më e shkurtër se 15 dite.

(4) Pelqim për vendimin për emërim të drejtorit, perkatesisht zëvendës drejtorit të Fondit jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(5) Drejtori i Fondit, perkatesisht zëvendës drejtori emërohet në kohezgjatje prej kater vitësh.

(6) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (5) i këtij neni, personi i njejte mund të riemërohet drejtor, perkatesisht zëvendës drejtor.

(7) Drejtori e perfaqeson dhe prezanton Fondin.

Neni 160

Drejtor perkatesisht zëvendës drejtor i Fondit emërohet personi fizik vendas, i cili do të ofroje program më kualitativ për punë të Fondit dhe që i ploteson kushtet si vijojne:

- të jete shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- arsimim të larte nga sfera e drejtesise, menaxhmentit, shkencave ekonomike, financave, administrimit të biznesit, shkencave elektroteknike,
- së paku pese vjet pervoje pune nga sfera e drejtesise, financave, ekonomise dhe sigurimit pensional dhe
- njohje të rregullave nga sfera e sigurimit pensional dhe invalidor.

Neni 161

Drejtori i fondit në kuader të të drejtave dhe detyrave të veta të percaktuara me kete ligj:

- 1) udheheq me Fondin dhe e prezanton dhe perfaqeson Fondin para personave të trete;
- 2) i propozon bazat e programit për punë dhe planin e punës dhe merr masa për zbatimin e tyre;
- 3) miraton akte për organizimin dhe punën e Fondit dhe akt të pergjithshem për sistematizimin e puneve në Fond në koordinim me Qeverinë;
- 4) i zgjedh dhe shkarkon punetoret me autorizime dhe pergjegjesi të posacme, organizon dhe siguron realizim të ligjshem dhe efikas të puneve në fusheveprimin e Fondit dhe eshte pergjegjes për ligjshmerine në punën e Fondit;
- 5) i propozon Këshillit Drejtues të Fondit ceshtje për debat dhe miraton vendime në kompetence të tij;
- 6) kujdeset për zbatimin e vendimeve, udhezimeve dhe konkluzioneve të miratuara të Këshillit Drejtues të Fondit;
- 7) i dorëzon Këshillit Drejtues të Fondit raporte dhe analiza për ceshtje nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe jep propozime për zgjidhjen e ceshtjeve për të cilat vendos Këshilli Drejtues i Fondit;
- 8) e organizon dhe koordinon punën e të punësuarve në Fond dhe vendos për realizimin e të drejtave dhe detyrave të tyre nga marrëdhënia e punës, në pajtim me ligjet dhe rregullat tjera nga marrëdhënia e punës dhe marreveshjet kolektive dhe

9) kryen edhe pune tjera të cilat me ligj, Statutin ose aktet tjera të përgjithshme janë lene në kompetence të tij.

Neni 162

(1) Drejtori, perkatesisht zevendesdrejtori mund të shkarkohet para kalimit të kohes për të cilën është emeruar:

- 1) me kerkese të tij;
- 2) nese krijohet ndonje prej shkaqeve, për të cilat sipas rregullave për marrëdhënie pune, i nderpritet marrëdhënia e punes me fuqi të ligjit;
- 3) nese nuk vepron sipas ligjit, Statutit dhe akteve të përgjithshme të Fondit ose në menyre të paarsyeshme nuk i zbaton vendimet e Keshillit Drejtues ose vepron në kundërshtim me to;
- 4) nese me punen e tij të pandërgjegjshme dhe të parregullt i shkakton Fondit dëm të konsiderueshem ose nese i anashkallon ose nuk i kryen obligimet e tij dhe për këte shkak krijohen ose do të mund të krijohen shkelje më të renda në veprimtarine e Fondit;
- 5) nese e pengon ose në menyre tjetër e pamundeson realizimin e të drejtave dhe detyrave të shfrytëzuesve të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor;
- 6) nese punon në kundërshtim me ligjin dhe
- 7) nese në afat prej dy tremujoreve të njëpasnjeshem Fondi tregon rezultate financiare negative në pune.

(2) Drejtori perkatesisht zevendesdrejtori i Fondit mund të shkarkohet nga detyra edhe me propozim të ministrit të Punes dhe Politikës Sociale në rastet nga paragrafi (1) pikat 3, 4, 6 dhe 7 të këtij neni, gjate realizimit të së drejtës së mbikeqyrjes.

Neni 163

- (1) Fondi ka Statut.
- (2) Me Statutin e Fondit vecanerisht rregullohen:
 - 1) organizimi dhe menyra e punes së Fondit;
 - 2) menyra e realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor në pajtim me ligjin;
 - 3) të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitet e organeve drejtuese të Fondit;
 - 4) perfaqesimi dhe prezantimi i Fondit;
 - 5) publiciteti në punen e Fondit dhe organeve të tij;
 - 6) menyra e organizimit dhe kryerja e puneve profesionale administrative juridike dhe puneve tjera në realizimin e sigurimit pensional dhe invalidor;
 - 7) procedura për miratimin e akteve të përgjithshme dhe të vecanta dhe
 - 8) ceshtje tjera me rëndësi për punen e Fondit.
- (3) Pelqim për Statutin e Fondit jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 164

(1) Punet udhëheqese, financiare, profesionale, administrative dhe punet tjera për realizimin e sigurimit pensional dhe invalidor, të percaktuara me ligj dhe Statutin e Fondit, janë pune me interes publik, të cilat i kryejne të punësuarit në Fond.

(2) Për kryerjen e puneve nga paragrafi (1) i këtij neni, Fondi formon sherbim unik profesional, filiale dhe dege.

(3) Të punësuarit në sherbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, që kryejne pune me interes publik në pajtim me ligjin, kanë status të nepunesve publike.

(4) Të punësuarit në sherbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, që kryejne pune ndihmese dhe teknike nuk kanë status të nepunesve publike dhe lidhur me të drejtat e tyre, obligimet dhe përgjegjësitet nga marrëdhënia e punes, zbatohen dispozitat e rregullave të përgjithshme nga marrëdhëniet e punes.

(5) Për të punesuarit në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, që kanë status të nepunesve publike për ceshtje të cilat kanë të bëjnë me punësimin, të drejtat dhe detyrat, përgjegjësitë, vlerësimin, ndërprerjen e punësimit, mbrojtjen dhe vendimmarrjen për të drejtat dhe obligimet e nepunesit publik, zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për nepunes publike.

(6) Kryerja e punëve të vecanta administrative në procedurë administrative për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor në pajtim me ligjin, ka karakter të autorizimeve publike, të cilat i kryen shërbimi unik profesional, filiali dhe dega e Fondit.

Neni 165

(1) Në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit për kryerjen e punëve me interes publik mund të punësohet person që i plotëson kushtet e përgjithshme dhe kushtet e vecanta të percaktuara me Ligjin për nepunes publike, si dhe kushtet tjera të percaktuara me aktin për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimet profesionale dhe filialet.

(2) Për plotësimin e vendit të lire të punës për kryerjen e punëve me interes publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, drejtori i Fondit miraton vendim për nevojën e punësimit të nepunesit publik.

(3) Me vendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, përcaktohet nëse plotësimi i vendit të lire të punës bëhet përmes punësimit të personit me shpallje të konkursit publik, me shpallje të konkursit intern, me sistemimin e nepunesve publike të punësuar ose me marrjen e nepunesit publik nga institucioni tjetër.

(4) Nëse plotësimi i vendit të lire të punës bëhet me shpallje të konkursit publik, Fondi dorezon kërkesë në Agjencinë e Administratës për shpallje të konkursit publik për punësim.

(5) Shpallja e konkursit nga paragrafi (4) i këtij neni dhe zbatimi i procedurës për zgjedhje, bëhen në pajtim me Ligjin për nepunes publike.

(6) Në rastet kur plotësimi i vendit të lire të punës bëhet me shpallje të konkursit intern, konkursi intern publikohet në ueb faqen e Fondit. Konkursi përmban të dhëna për vendin e punës që duhet të plotësohet, kushtet e vecanta të percaktuara me nenet 15 dhe 19 të Ligjit për nepunes publike, kushtet e percaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës, që duhet t'i plotësojë nepunesi publik dhe afatin e paraqitjes.

Neni 166

(1) Nepunesi publik i punësuar në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, i cili ka arsimim perkates, përvojë të nevojshme të punës në profesion dhe i plotëson edhe kushtet tjera të percaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës, sipas nevojës së shërbimit unik profesional, filialeve dhe degeve të Fondit ose me kërkesë të tij, mund të sistemohet në vend tjetër të punës në pajtim me aktin për sistematizim të vendeve të punës, ose të merret në institucion tjetër, nëse për këtë e ka pelqimin e personave udhëheqës të institucioneve.

(2) I punësuar i cili nuk ka status të nepunesit publik, e që ka arsimim perkates, përvojë të nevojshme të punës dhe i plotëson edhe kushtet tjera të percaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimet profesionale, sipas nevojës ose me kërkesë të tij, mund të merret ose sistemohet, në vend pune me titullin perkates në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit dhe ta fitojë statusin e nepunesit publik.

(3) I punësuar nga paragrafi (2) i këtij neni është i obliguar që në afat prej gjashtë muajsh nga dita e marrjes ose sistemimit të tij, të japë provim të nepunesit publik.

(4) Personat që punësohen për herë të parë në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit për kryerjen e punëve me interes publik dhe personat që punësohen në vend më të lartë të punës nga ai paraprak në shërbimin profesional, detyrimisht kryejnë punë provuese. Puna provuese për kandidatin e zgjedhur për nepunes publik me arsimim të lartë zgjat 12 muaj, ndërsa për kandidatin e zgjedhur me arsimim të mesëm dhe personin që punësohet në vend më të lartë të punës nga ai paraprak, puna provuese zgjat gjashtë muaj.

(5) Për menyren e kryerjes së punes provuese dhe punesimin e personave të zgjedhur nga paragrafi (3) i ketij neni, zbatohen dispozitat nga Ligji për nepunes publike.

Neni 167

Nepunesi publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, personalisht është përgjegjës për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës nga vendi i punës.

Neni 168

(1) Çdo nepunes publik dhe person tjetër, në pajtim me ligjin, ka të drejtë të paraqesë iniciative për ngritjen e procedurës disiplinore kundër nepunesit publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, e cila duhet të jetë e arsyetuar.

(2) Propozim për ngritjen e procedurës disiplinore kundër nepunesit publik paraqet nepunesi publik epror i drejtperdrejte, perkatesisht nepunesi udheheqes ose drejtori i Fondit.

Neni 169

(1) Propozimi për ngritje të procedurës për percaktimin e përgjegjësise disiplinore sipas rregullës i përmban elementet e vijojnë:

- emrin personal të nepunesit publik për të cilin parashtrohet propozimi për ngritjen e procedurës për percaktimin e përgjegjësise disiplinore,
- vendin e punës në të cilin është sistemuar nepunesi publik për të cilin parashtrohet propozimi,
- përkrahje të veprimit/eve me të cilin është kryer shkëlja e rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësimi i detyrimeve të punës,
- shenim të kualifikimit të veprimit/eve nga alineja 3 të ketij paragrafi, me shenim konkret nëse kjo sipas vlerësimit paraqet shkëlje më të lehtë, perkatesisht më të rënde të rendit dhe disiplinës së punës ose mosplotësim të detyrave të punës,
- kohën, menyren dhe vendin e kryerjes së veprimit me të cilin është kryer shkëlja e rendit dhe disiplinës së punës ose mosplotësimi i detyrimeve të punës,
- pasojat që janë shkaktuar në rendin dhe disiplinën e punës dhe mosplotësimin e detyrave të punës,
- shenim të deshmise/ve nga të cilat vërtetohet sjellja e tillë, perkatesisht deshmise që është në dobi të faktit se është kryer veprim i kompletuar (shenim zyrtar, raport me shkrim, informate, fletëparaqitje, deklarate nga deshmitare e ngjashëm),
- shenim të emrit personal të personit që mund të thirret në cilesinë e deshmitarit,
- të dhëna nëse nepunesi publik për të cilin paraqitet propozimi deri atëherë është përgjigjur për shkëljen e rendit dhe disiplinës së punës ose mosplotësimin e detyrave të punës në ndërmarrjen publike dhe
- të dhëna lidhur me shpërblimet paraprake të nepunesit publik.

(2) Në shtojcë të propozimit nga paragrafi (1) i ketij neni dorezohen deshmite që përmenden në dokumentin e njëjte dhe të tjera që sipas vlerësimit të propozuesit janë me rëndësi për rastin konkret.

Neni 170

(1) Drejtori i Fondit formon komision për udheheqjen e procedurës disiplinore për kundërvajtje disiplinore në afat prej tetë ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit për ngritjen e procedurës disiplinore.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i ketij neni, përbehet nga tre anëtarë si vijojnë, një nepunes publik udheheqës dhe dy nepunes publike prej të cilëve njëri me titull nga grupi i njëjte i titullit si edhe nepunesi publik kundër të cilit udhëhiqet procedura disiplinore, ndërsa tjetri është përfaqësues i sindikates.

(3) Anetaret e Komisionit kane zevendes.

(4) Kryetari i Komisioni eshte nga radhet e nepunesve shteterore udheheqes.

(5) Komisioni nga paragrafi (1) i ketij neni, pas procedures së zbatuar disiplinore i propozon mase perkatese disiplinore drejtorit të Fondit.

(6) Nese Komisioni nga paragrafi (1) i ketij neni konstaton se nepunesi publik nuk eshte pergjegjes ose nuk jane plotesuar kushtet për miratimin e aktvendimeve për shqiptimin e mases disiplinore, i propozon drejtorit që ta hedh poshte propozimin, perkatesisht ta nderprese proceduren.

Neni 171

(1) Masat disiplinore kunder nepunesit publik në sherbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, i shqipton drejtori i Fondit, me raport paraprak me shkrim nga nepunesi publik epror i drejtperdrejte.

(2) Para shqiptimit të mases disiplinore nepunesi publik njoftohet me shkrim për provat e raportit nga paragrafi (1) i ketij neni, që ekzistojne kunder tij dhe ai ka të drejte të jape pergjigje me goje apo me shkrim në afat i cili nuk mund të jete më i shkurter se tete dite.

(3) Nese nepunesi publik nuk deshiron ta pranoje njoftimin për deshmite në raportin nga paragrafi (1) i ketij neni, në afat prej tri ditesh, ai do të publikohet në tabelen e shpalljeve në seline e sherbimit profesional.

(4) Drejtori i Fondit në afat prej 60 ditesh nga dita e fillimit të procedures miraton aktvendim për shqiptimin e mases disiplinore.

Neni 172

Kunder aktvendimit për shqiptimin e mases disiplinore, nepunesi publik në sherbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, ka të drejte ankese në afat prej tete ditesh në Agjencine e Administrates.

Neni 173

(1) Nepunesi publik në sherbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit eshte pergjegjes për demin i cili në pune ose lidhur me punen me qellim ose nga pakujdesia ia ka shkaktuar sherbimit profesional.

(2) Drejtori i Fondit formon komision për percaktimin e pergjegjesise materiale të nepunesit publik.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni, perbehet nga kryetari dhe dy anetare prej të cileve njeri eshte nepunes publik ndersa tjetri eshte perfaqesues i sindikates dhe zevendesit e tyre. Kryetari i komisionit eshte nepunes publik udheheqes ose nepunes publik i cili nuk eshte me titull më të ulet nga titulli i nepunesit publik kunder të cilit udhehiqet procedura për pergjegjesi materiale.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni e percakton pergjegjesine materiale për ekzistimin e demit të kryer material, lartesine e tij dhe menyren e kryerjes, kush e ka shkaktuar demin dhe kush do ta kompensoje.

(5) Komisioni nga paragrafi (2) i ketij neni për gjendjen e konstatuar faktike parashtron raport në baze të të cilit drejtori i Fondit miraton aktvendim për kompensim të demit.

Neni 174

Propozim për ngritjen e procedures për percaktimin e pergjegjesise materiale kunder nepunesit publik në sherbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, paraqet nepunesi publik epror i drejtperdrejte, perkatesisht nepunesi udheheqes ose drejtori i Fondit.

Neni 175

Kunder aktvendimit nga neni 173 paragrafi (5) i ketij ligji, nepunesi publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, ka të drejte të paraqese ankese në Agjencine e Administrates në afat prej tete ditesh nga dita e dorezimit të aktvendimit.

Neni 176

Nepunesi publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit në baze të ndjekjes së vazhdueshme të punes vleresohet nga nepunesi publik udheheqes epror i drejtperdrejte, në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit.

Neni 177

Vleresimi i nepunesit publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit behet me qellim që të fitohet pasqyre reale për profesionalizmin, kualitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në kryerjen e puneve me interes publik të percaktuara me ligj.

Neni 178

Vleresimi i nepunesit publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit kryhet në baze të të dhenave për rezultatet e punes dhe kualitetet personale duke i pasur parasysh të dhenat për trajnimet, shperblimet, masat disiplinore dhe mungesat në vitin paraprak.

Neni 179

Gjate vleresimit të rezultateve të punes, kryhet vleresimi i njohjes dhe zbatimit të rregullave dhe praktikave, realizimi i qellimeve të punes, kryerja me kohe e punes, kryerja cilesore e punes dhe organizimi i punes në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit.

Neni 180

Gjate vleresimit të kualiteteve personale kryhet vleresim i kreativitetit, iniciatives dhe interesimit për pune, aftesise për pune në ekip, aftesise për pune nën presion dhe i shkathtesive komunikuese.

Neni 181

Vleresimi kryet në menyre objektive dhe të paanshme, pa ndikim dhe presion nga nepunes publike eprore të drejtperdrejte dhe nepunes udheheqes në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit mbi vleresuesin.

Neni 182

Vleresimi behet si proces i vazhdueshem gjashtemujor i vleresimit të rezultateve të punes dhe kualiteteve personale të të vleresuarit, që i perfshin:

- percaktimin e qellimeve dhe aktiviteteve të punes,
- ndjekjen dhe grumbullimin e të dhenave në punen e nepunesit publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit,
- dhenien e instruksioneve dhe keshillave për permiresimin e punes dhe
- interviste me nepunesin publik.

Neni 183

(1) Vleresuesi gjate periudhes se vleresimit, vazhdimisht e ndjek punen e nepunesit publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit dhe grumbullon të dhena që jane me rendesi esenciale për vleresimin.

(2) Ndjekja dhe grumbullimi i të dhenave nenkupton kontroll dhe evidentim të kualitetit dhe kuantitetit në realizimin e detyrave të punes.

(3) Gjate ndjekjes së punes, vleresuesi vazhdimisht e motivon nepunesin publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit dhe i jep instruksione dhe keshilla për permiresimin e punes, i sugjeron për detaje konkrete në pune, për procedurat që shpien në pune të suksesshme dhe për mangesite në punen e tij.

Neni 184

Gjate vleresimit të punes së nepunesit publik në shërbimin unik profesional, filialet dhe deget e Fondit, aplikohet formulari për vleresimin e nepunesit publik i percaktuar në pajtim me Ligjin për nepunes publike.

Neni 185

(1) Shtepite dhe banesat për jetese të shfrytezuesve të pensionit, objektet e dedikuara për klube për qëndrim ditor, objektet e dedikuara për pushim dhe rekreacion të shfrytezuesve të pensionit dhe objektet tjera që janë pronesi shteterore, i menaxhon Fondi.

(2) Fondi me akt të pergjithshem i percakton funksionin dhe veprimtarine e ketyre objekteve, si dhe menyren dhe kushtet e punes së tyre.

Neni 186

(1) Ministria e Punes dhe Politikës Sociale kryen mbikeqyrje mbi punen dhe ligjshmerine e punes së Fondit.

(2) Ministria e Punes dhe Politikës Sociale mund ta nderprese realizimin e aktit të pergjithshem të Fondit, nese nuk eshte në perputhje me kete ligj ose nuk eshte në perputhje me Kushtetuten, deri miratimin e Vendimit të Gjykates Kushtetuese.

Kreu XIV

Sigurimi i mjeteve për sigurim pensional dhe invalidor

Neni 187

(1) Mjetet e nevojshme për realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor sigurohen me:

1) pagese të kontributit nga rrogat e punetoreve, nga baza e sigurimit për personat fizike, si dhe nga baza e sigurimit të bujqve individuale varesisht nga lartesia e të hyrave të realizuara kadastrale;

2) të hyra nga dividenda të aksioneve dhe fitimit nga pjesëmarrjet;

3) të hyra nga kamatat e obligacioneve dhe bonove të thesarit;

4) nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë;

5) nga të hyrat nga fondet e sigurimit pensional dhe invalidor të ish-republikave të RSFJ-së, te të cilat eshte kryer pjesa e stazhit të sigurimit;

6) nga prona e Fondit, shitja e prones së Fondit;

7) pjese të shumës së akcizes së paguar të vajrave minerale të shënuara në nenin 28 paragrafi

(1) pikat 1, 2 dhe 5 të Ligjit për akciza dhe

8) nga të hyra tjera.

(2) Shitja e prones së Fondit do të kryhet nepermjet ankandit publik, në pajtim me Ligjin për shfrytezim dhe disponim me sende të organeve shteterore.

Neni 188

Mjetet për sigurim pensional dhe invalidor mund të shfrytezohen vetem për dedikime të percaktuara me Ligjin, si vijojne:

1) për pagese të pensioneve dhe të hyrave tjera në para nga sigurimi pensional dhe invalidor;

2) për kontribut për sigurim shendetesor;

3) për kompensime për stazhin e realizuar në Fond kur pensioni në baze të atij stazhi realizohet në fondet e sigurimit pensional dhe invalidor të ish-republikave të RSFJ-së dhe

4) shpenzime për punën e organit të Fondit dhe për kryerjen e punëve udhëheqëse, administrative, financiare, teknike dhe punëve tjera për realizimin e sigurimit pensional dhe invalidor.

Neni 189

Me kontributin për stazhin e sigurimit që llogaritet me kohezgjatje të shtuar sigurohen mjete për mbulimin e detyrimeve të shtuara të sigurimit pensional dhe invalidor, të cilat krijohen për shkak të llogaritjes së stazhit të sigurimit me kohezgjatje të shtuar dhe zvogelimit të kufirit të moshës për fitimin e së drejtës për pension të pleqërisë.

Neni 190

Për personat të cilët nuk kanë cilesi të të siguruarit, e me këto ligj janë të siguruar për raste të caktuara, llogaritet dhe paguhet kontribut për sigurim në rast të invaliditetit dhe demtimit trupor nga baza dhe sipas shkalleve ose në shuma fikse që i përcakton Fondi me akt të përgjithshëm.

Neni 191

Mjetet e fituara me shitjen e pronës së Fondit, shfrytëzohen për dedikime të përcaktuara me nenin 188 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 192

Mjetet për mbulimin e detyrimeve të sigurimit pensional dhe invalidor që krijohen me pranimin dhe përcaktimin e pensioneve në kushte më të volitshme, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 193

(1) Fondi mund të realizojë edhe mjete nga shitja e aksioneve dhe pjesëmarrjeve, më së shumti deri në 100% nga kapitali i përgjithshëm i fituar në baze të transformimit të ndermarrjeve me kapital shoqëror.

(2) Me kapital të përgjithshëm të cilin Fondi e ka fituar në baze të transformimit të ndermarrjeve me kapital shoqëror nenkuptohen: kapitali në aksione dhe pjesëmarrje në shoqëri aktive, aksionet dhe pjesëmarrjet e shitura, aksionet dhe pjesëmarrjet në shoqëri në të cilat është hapur procedura e falimentimit ose procedura për likuidim, e që ende nuk ka përfunduar. Në kapitalin e përgjithshëm nuk janë përfshirë aksionet dhe pjesëmarrjet nga shoqëritë e likuiduara.

(3) Vendimin për shitje të aksioneve dhe pjesëmarrjeve nga kapitali i përgjithshëm i fituar në baze të transformimit të ndermarrjeve me kapital shoqëror e miraton Këshilli Drejtues i Fondit, me propozim të Komisionit për aksione dhe pjesëmarrje, pas pelqimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(4) Komisionin për aksione dhe pjesëmarrje e formon drejtori i Fondit si trup këshillëdhënës, që përbëhet nga shtatë anëtarë, persona profesioniste dhe kompetente nga sfera e punës ekonomike dhe financiare, prej të cilëve dy anëtarë i cakton drejtori i Fondit, ndërsa nga një anëtar i cakton ministri i Ekonomisë, Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, Ministri i Financave, zëvendës kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i ngarkuar për çështje ekonomike dhe sekretari i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(5) Procedura për shitjen e aksioneve dhe pjesëmarrjeve nga kapitali i përgjithshëm i fituar në baze të transformimit të ndermarrjeve me kapital shoqëror, më afërsisht e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(6) Me mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni Fondi mund të blejë obligacione të Republikës së Maqedonisë më së shumti deri 50% nga mjetet e realizuara me shitjen e aksioneve dhe pjesëmarrjeve.

(7) Fondi për shitjen e aksioneve dhe pjesemarrjeve nga kapitali i pergjithshem i fituar në baze të transformimit të ndermarrjeve me kapital shteteror, si dhe për obligacionet dhe bonat e blera të thesarit, e njofton Qeverine e Republikes së Maqedonise në çdo tre muaj në vitin rrjedhes.

Kreu XV

Evidenca amë

Neni 194

(1) Fondi themelon dhe mban evidence amë e cila permban të dhena të nevojshme për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor.

(2) Në evidencen amë mbahen të dhena për të siguruarit, shfrytezuesit e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe detyresit për llogaritjen dhe pagesen e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

(3) Në grumbullimin perpunimin, shfrytezimin, shkembimin dhe ruajtjen e të dhenave, zbatohen dispozitat e ligjit që e rregullojne mbrojtjen e të dhenave personale.

Neni 195

(1) Të dhenat që mbahen në evidencen amë, Fondi i merr nga detyresit për paraqitjen e të dhenave të percaktuara me kete ligj, që njekohesisht jane edhe detyres për llogaritje dhe pagese të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor.

(2) Të dhenat që mbahen në evidencen amë, Fondi pa pagese të kompensimit, i merr edhe nga sherbimet ose organet tjera të cilat vendosin, mirembajne dhe shfrytezojne permbledhje të të dhenave për realizimin detyrave të tyre të percaktuara me ligj (në tekstin e metejme: dhenes të të dhenave).

Neni 196

(1) Evidenca amë mbahet sipas parimeve unike metodologjike.

(2) Në evidencen amë futen të dhenat sipas standardeve unike nacionale.

(3) Futja e të dhenave në evidencen amë behet sipas kodeksit unik të shifrave.

(4) Të dhenat futen në baze të formulareve të percaktuar të fleteparaqitjeve, që plotesohen në baze të dokumenteve publike dhe evidencave të percaktuara me ligj, që i mbajne detyresit për paraqitjen e të dhenave dhe dhenesit e të dhenave.

Neni 197

(1) Të dhenat nga evidencia amë shfrytezohen për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor.

(2) Të dhenat nga evidencia amë shfrytezohen edhe për nevojat e shtylles së dyte dhe të trete.

(3) Të dhenat nga paragrafi (1) i ketij neni mund të shfrytezohen edhe për hulumtime statistikore dhe shkembim të të dhenave me institucione me të cilat Fondi ka lidhur marreveshje.

Të dhena që futen në evidencen amë

Neni 198

Në evidencen amë futen të dhenat për:

1) të siguruarit e perfshire me dispozitat e ketij ligji;

2) personat që kane realizuar të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonise sipas rregullave të sigurimit pensional dhe invalidor (në tekstin e metejme: shfrytezues të të drejtave) dhe

3) detyresit për llogaritje dhe pagese të kontributit për sigurim pensional dhe invalidor (në tekstin e metejme: detyres për llogaritje dhe pagese të kontributit).

Neni 199

Fleteparaqitjet me të dhena për vendosjen dhe udheheqjen e evidences amë, i dorezojnë detyresit për paraqitjen e të dhenave:

- 1) punedhenesit - për punetoret e punesuar te ata;
- 2) personat e vetepunesuar - për veten e tyre dhe për të punesuarit te ata;
- 3) bujqit individuale dhe personat zyrtare fetare - për vetveten;
- 4) institucionet shtetërore, organet ose organizatoret, që kane obligim ligjor që të paraqesin të dhena për të siguruarit në sigurim pensional dhe invalidor dhe
- 5) drejtoret e falimentimit për të siguruarit që kane qene të punesuar te punedhenes për të cilet udhehiqet procedure e falimentimit.

Vendosja dhe udheheqja e evidences amë

Neni 200

(1) Evidenca amë për të siguruarit dhe detyresit për llogaritje dhe pagese të kontributit, mbahet ashtu që të dhenat, dorezohen në menyre elektronike në forme të percaktuar elektronike, e me perjashtim, në baze të formulareve të percaktuar të fleteparaqitjeve dhe futen në mjetet për perpunim automatik të të dhenave të Fondit.

(2) Evidenca amë për shfrytëzuesit e të drejtave, vendoset dhe udhehiqet në baze të të dhenave nga evidenca amë e të siguruarve dhe aktvendimeve të miratuara për të drejtat e njohura nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Neni 201

(1) Për vendosjen dhe udheheqjen e evidences amë kompetente jane filialet dhe degët e Sherbimit profesional të Fondit si vijon, për:

- 1) të siguruarit nga neni 11 pikat 1, 2, 3, 4, 11, 12, 13 dhe neni 14 pikat 1, 3, dhe 4 të këtij ligji, sipas selise së punedhenesit, perkatesisht selise së njesise afariste;
- 2) të siguruarit nga neni 11 pikat 7 dhe 8 dhe neni 14 pika 2 të këtij ligji, sipas vendit ku eshte regjistruar veprimtaria;
- 3) të siguruarit nga neni 11 pikat 5 dhe 6 të këtij ligji, sipas vendbanimit që e ka pasur i siguruari para largimit në vend të huaj;
- 4) të siguruarit nga neni 11 pika 9 e këtij ligji, sipas vendbanimit, perkatesisht vendqendrimit;
- 5) të siguruarit nga neni 11 pika 10 e këtij ligji, sipas selise së qendres për punesim ku eshte i paraqitur i siguruari;
- 6) të siguruarit nga neni 12 i këtij ligji, sipas filialit, perkatesisht deges ku ka qene për here të fundit i paraqitur në sigurimin e detyrueshem pensional;
- 7) personat nga nenet 15 dhe 16 të këtij ligji, sipas selise së detyresit për llogaritje dhe pagese të kontributit;
- 8) të siguruarit për të cilet filiali, perkatesisht dega e percaktojnë cilesine e të siguruarit sipas selise së filialit, perkatesisht deges së Sherbimit profesional të Fondit, që ka vendosur për të drejten;
- 9) të siguruarit që shfrytëzojnë të drejte të kompensimit të rrogës për pune me orar të shkurtuar të punes për shkak të kurimit të femijes me hendikep sipas selise së Qendres për pune sociale dhe
- 10) shfrytëzuesit e të drejtave - sipas selise së filialit, perkatesisht Qendres së Sherbimit profesional të Fondit ku eshte realizuar e drejta.

(2) Menyren e udheheqjes së evidences amë dhe kodeksit unik të shifrave për futjen e të dhenave në evidencen amë, i percakton Fondi.

Paraqitja e të dhenave për mbajtjen e evidences amë

Neni 202

(1) Detyresit për paraqitjen e të dhenave dhe dhenesit e të dhenave jane pergjegjes për saktesine e të dhenave të dorezuara.

(2) Detyresit për paraqitjen e të dhenave dhe dhenesit e të dhenave, janë të obliguar që Fondit t'i a dorezojnë të dhenat, ndryshimet, perkatesisht korrigjimet të cilat ndikojnë në të dhenat, në afatin dhe formen e caktuar.

(3) Gjate paraqitjes së të dhenave në forme elektronike dhe percaktimin e autenticitetit të të dhenave dhe identitetit të nenshkruesit, zbatohen dispozitat e ligjit që e rregullon punen elektronike dhe perdorimin e të dhenave në forme elektronike dhe nenshkrimin elektronik.

Procedura për percaktimin e të dhenave në evidencen amë

Neni 203

(1) Fondi është kompetent që ta percaktojë saktësinë dhe teresinë e të dhenave, në baze të shikimit në dokumentacionin origjinal të detyresit për paraqitjen e të dhenave dhe evidencen për të dhenat mujore të kontributit të llogaritur dhe të paguar, për çdo të siguruar veç e veç.

(2) Detyresit për paraqitjen e të dhenave janë të obliguar që Fondit t'i mundesojnë qasje në evidencen personale për kontroll të saktësisë dhe teresisë së të dhenave të paraqitura.

Neni 204

(1) Fondi mund të percaktojë cilesi të të siguruarit, me plotësimin e fletëparaqitjes së sigurimit me detyre zyrtare, kur do të konstatojë se nuk është parashtruar fletëparaqitje për sigurim të personit, i cili ka të drejtë në sigurim pensional dhe invalidor.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen edhe në rastet kur detyresit për dorezimin e të dhenave nuk ka parashtruar cregjistrim të sigurimit.

(3) Fondi, mund të perpilojë me detyre zyrtare, fletëparaqitje për fillim, nderprerje ose ndryshim në punën e detyresit për llogaritje dhe pagese të kontributeve, në baze të dokumenteve publike dhe evidencave të percaktuara me ligj.

Neni 205

(1) Të dhenat për stazhin e sigurimit, rrogat, kompensimet e rrogës, perkatesisht bazat e sigurimit, që janë baze për percaktimin e bazës pensionale dhe të drejtës së pensionit, i percakton Fondi në pajtim me rregullat për sigurim pensional dhe invalidor.

(2) Fondi, mund të perpilojë me detyre zyrtare, fletëparaqitje me të dhëna për stazhin e sigurimit, rrogat, kompensimet, perkatesisht bazat e sigurimit në baze të dokumenteve publike dhe evidencave të percaktuara me ligj.

Neni 206

(1) Nëse Fondi gjate kontrollit të të dhenave, konstaton se të dhenat nuk janë paraqitur në mënyrë të rregullt nga detyresit për paraqitjen e të dhenave, do ta obligojë që t'i permiresojë të dhenat, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorezimit të kërkesës.

(2) Nëse detyresit për paraqitjen e të dhenave në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i permireson të dhenat, Fondi me detyre zyrtare do t'i percaktojë të dhenat në pajtim me rregullat e sigurimit pensional dhe invalidor.

Neni 207

(1) Fondi është i detyruar që me kërkesë të të siguruarit, t'i japë vertetim për të dhenat e futura në evidencen amë.

(2) Vertetimi nga paragrafi (1) i këtij neni ka karakter të dokumentit publik.

(3) I siguruari që nuk është i kenaqur me të dhenat e futura në evidencen amë, ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh nga dita e dorezimit të vertetimit, të kërkojë që Fondi të miratojë aktvendim për të dhenat e percaktuara në evidencen amë.

(4) Fondi është i obliguar që ta miratojë aktvendimin nga paragrafi (3) i këtij neni në afat prej 5 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(5) Kunder aktvendimit nga paragrafi (4) i ketij neni, i siguruari ka të drejte ankese në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në procedure administrative dhe procedure nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë.

(6) Kunder aktvendimit të shkallës së dytë nga paragrafi (5) i ketij neni, i siguruari mund të ngrite kontest administrativ.

Neni 208

(1) Të dhenat e futura në evidencen amë, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj, në mënyrë plotësuese mund të ndryshohen në rastet si vijojnë:

1) nëse organi kompetent në mënyrë plotësuese konstaton ndryshim të të dhënave;

2) nëse të dhenat për cilësinë e të siguruarit, për stazhin e sigurimit, rrogat, kompensimet e rrogave, perkatesisht bazave të sigurimit që shërbejnë për përcaktimin e bazës pensionale, janë futur në baze të dokumenteve të rrejshme;

3) nëse në mënyrë plotësuese me kontrollin e të dhënave ose në mënyrë tjetër konstatohet se në evidencen amë janë futur të dhëna të parregullta, të pasakta ose të paplota dhe

4) në raste tjera që sipas rregullave mund të perdoren mjete juridike të jashtëzakonshme.

(2) Ndryshimi i të dhënave nga paragrafi (1) i ketij neni, të futura në evidencen amë kryhet në procedure të përcaktuar me këtë ligj.

Afatet për paraqitjen e të dhënave për udhëheqjen e evidences amë dhe përpunimin e tyre

Neni 209

Fletëparaqitje për të dhenat për udhëheqjen e evidences amë nga neni 199 i ketij ligji dorezohen në afatet si vijojnë:

1) për të dhenat për fillimin, perkatesisht përfundimin e punës dhe ndryshimet gjatë punës së detyrës për pagesë të kontributit-në afat prej tete diteve të punës nga dita e fillimit, perkatesisht përfundimit të punës, perkatesisht nga dita e ndryshimit të shkaktuar gjatë punës;

2) për të dhenat për fillimin, perkatesisht përfundimin e sigurimit, dhe ndryshimet gjatë sigurimit-në afat prej tete diteve të punës nga dita e fillimit, perkatesisht përfundimit të marrëdhënies së punës ose nga dita e plotfuqishmerisë së aktvendimit për përcaktimin e cilësisë së të siguruarit;

3) për të dhenat për stazhin e sigurimit, rrogat, kompensimet e rrogez, perkatesisht bazat e sigurimit, merren nga evidencat për të dhenat mujore për kontribut të perllogaritur dhe të paguar pa obligim për parashtrimin e atyre të dhënave në nivel vjetor - më së voni deri në fund të prillit të vitit rrjedhës për vitin e kaluar kalendarik;

4) për ndryshimin e të dhënave për stazhin e sigurimit, rrogat kompensimet e rroges, perkatesisht bazat e sigurimit - në afat prej tete diteve të punës nga dita kur është konstatuar ndryshimi i të dhënave;

5) për të dhenat për stazh të përcaktuar pensional plotësues, perkatesisht për rritjen e stazhit të sigurimit - në afat prej tete diteve të punës nga dita e plotfuqishmerisë së aktvendimit, perkatesisht nga dita e përcaktimit të gjendjes faktike për punët për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohezgjatje të rritur;

6) për të dhenat për invalidet e punës me aftësi pune të zvogëluar, perkatesisht të mbetur dhe ndryshimin e atyre të dhënave - në afat prej tete diteve të punës nga dita e plotfuqishmerisë së aktvendimit, me të cilin është përcaktuar invaliditeti, perkatesisht ndryshimi i shkaktuar;

7) për të dhenat për kompensimet në para për invalidet e punës me aftësi pune të zvogëluar, perkatesisht të mbetur - më së voni deri në fund të prillit të vitit rrjedhës për vitin e kaluar kalendarik dhe

8) për ndryshimin e të dhënave për kompensimet në para për invalidet e punës me aftësi pune të zvogëluar, perkatesisht të mbetur në afat prej tete diteve të punës nga dita kur është konstatuar ndryshimi i të dhënave.

Neni 210

Fondi eshte i obliguar që t'i fute të dhenat në evidencen amë në afatet si vijojne:

- 1) të dhenat nga neni 209 pikat 1 dhe 2 të ketij ligji - menjehere, e më së voni në afat prej tri diteve të punes nga dita e paraqitjes së të dhenave;
- 2) të dhenat nga neni 209 pikat 3 dhe 7 të ketij ligji futen menjehere pas percaktimit të saktësisë dhe teresisë së të dhenave, e më së voni deri më 30 qershor të vitit rrjedhes, për të dhenat nga viti i kaluar kalendarik;
- 3) të dhenat nga neni 209 pika 6 e ketij ligji - në afat prej tete diteve të punes nga dita e plotfuqishmerise së aktvendimit dhe
- 4) të dhenat për ndryshimin e të dhenave nga neni 209 pikat 4 dhe 5 dhe 8 të ketij ligji - në afat prej tete diteve të punes nga dita e paraqitjes së të dhenave.

Ruajtja e dokumentacionit nga evidenca amë

Neni 211

(1) Dokumentacioni që sherben për vendosjen dhe udheheqjen e evidences amë, ruhet së paku 30 vite, duke llogaritur nga dita e marrjes së të drejtave të percaktuara në baze të atij dokumentacioni, por jo më pak se dhjete vite nga perfundimi i shfrytezimit të të drejtave, perkatesisht nga vdekja e shfrytezuesit të të drejtave.

(2) Dokumentacioni për personat për të cilet udhehiqen të dhena në evidencen amë, e që nuk kane fituar të drejta nga sigurimi pensional dhe invalidor, ruhen së paku 40 vite, duke llogaritur nga futja e fundit e të dhenave në evidencen amë.

Neni 212

(1) Dokumentacioni nga evidenca amë ruhet në medime elektronike për sigurim të reproduksionit të të dhenave në format origjinal.

(2) Fotokopja e verifikuar e të dhenave nga paragrafi (1) i ketij neni, trajtohet si dokument zyrtar dhe sherben për deshmimin e fakteve të futura në evidencen amë.

(3) Fotokopjen e fleteparaqitjes origjinale e verifikon Fondi.

Neni 213

(1) Pas kalimit të afateve nga neni 211 i ketij ligji, asgjesimin e dokumentacionit nga evidenca amë e kryen komision profesional i perbere nga pese anetare që e formon Fondi.

(2) Kryetar i komisionit nga paragrafi (1) i ketij neni eshte perfaqesues nga Arkivi Shteteror i Republikës së Maqedonise, kurse anetaret zgjidhen nga të punesuarit e Fondit.

(3) Komisioni nga paragrafi (1) i ketij neni, i asgjeson edhe fleteparaqitjet origjinale pas bartjes së tyre në medimet magnetike-optike.

Mbrojtja e të dhenave nga evidenca amë

Neni 214

(1) Të dhenat e futura në evidencen amë të Fondit llogariten si sekret zyrtar, nese me kete ligj nuk eshte rregulluar ndryshe.

(2) Sekret zyrtar nga paragrafi (1) i ketij neni nuk llogaritet shfrytezimi i të dhenave në pajtim me nenin 197 paragrafi (2) të ketij ligji.

(3) Personat e punesuar në Fond që gjate punes së tyre njoftohen me permbajtjen e të dhenave personale për të siguruarit dhe shfrytezuesit e të drejtave, ato të dhena jane të obliguar që t'i ruajne si sekret zyrtar.

(4) Detyrimi për ruajtjen e sekretit zyrtar nga paragrafi (3) i ketij neni, zgjat edhe pas nderprerjes së marrredhenies së punes.

(5) Gjate shfrytezimit të të dhenave nga evidenca amë e Fondit për hulumtime statistikore dhe regjistra statistikore, do të sigurohet mbrojtje e të dhenave në pajtim me dispozitat e Ligjit për statistike shteterore.

Neni 215

(1) Mbrojtjen e të dhenave, Fondi e siguron përmes marrjes së masave kundër personave që kryejnë qasje të paautorizuar apo përpunim të paautorizuar të të dhenave, si edhe masave me të cilat pengohet asgjësimi, humbja, ndryshimi, keqperdorimi dhe perdorimi i paautorizuar i të dhenave.

(2) Masat teknike dhe organizative për sigurimin e të dhenave nga evidenca amë, Fondi i përcakton me akt të përgjithshëm.

Kreu XVI

Kompensimi i demit

Neni 216

(1) Personi të cilit i është kryer pagesa në ngarkim të Fondit, për të cilin nuk ka pasur të drejte, është i detyruar që ta kthejë shumën e pranuar dhe ta kompensojë tërësisht demin tjetër, si vijon:

1) nese në bazë të të dhenave të pasakta për të cilat ka ditur ose ka qenë i detyruar që të dije se janë të pasakta ose në mënyrë tjetër të paligjshme ka realizuar të ardhura nga Fondi për të cilat nuk ka pasur të drejte ose e ka realizuar në shumë më të madhe se sa i ka takuar dhe

2) nese ka realizuar të ardhura për shkak se nuk ka paraqitur, ose me vonese i ka paraqitur ndryshimet që ndikojnë në humbjen, përkatesisht shfrytëzimin e të drejtës ose të lartësisë së saj, e që e ka ditur se është i detyruar që të dije për ato ndryshime.

(2) Personi të cilit i janë kryer pagesat në shumë më të madhe se shumata e përcaktuar në aktvendim, përkatesisht dokument tjetër përkates, është i detyruar që t'ia kthejë Fondit shumata që i takojnë, pavarësisht nga i siguruari.

Neni 217

Punedhënesit, të siguruarit që janë vetë detyrues për pagesën e kontributit dhe personat tjerë juridike dhe fizike, janë të obliguar që ta kompensojnë demin e shkaktuar ndaj Fondit, për të cilin janë përgjegjës në pajtim me rregullat për kompensim të demit, duke e përfshirë edhe përgjegjësinë e demit të kryer me veprime të palejueshme ose leshime të tjetrit, ose që është bërë me mjete nga të cilat rezulton rrezik i zmadhuar.

Neni 218

Kur demin është kryer me pagesa në bazë të invaliditetit, demtimit trupor ose vdekjes së të siguruarit, të shkaktuara me veprim të paligjshëm ose me leshim, ekziston obligim për kompensim të demit pa marrë parasysh se rreziku i invaliditetit, demtimit trupor ose vdekjes janë përfshirë me sigurimin pensional dhe invalidor.

Neni 219

(1) Kompensimi i demit të shkaktuar në nenet 216 dhe 218 të këtij ligji i përfshin të gjitha shpenzimet në para të paguara në bazë të së drejtës së pranuar nga sigurimi pensional dhe invalidor, me ç'rast nuk llogariten shumata e kontributeve të paguara për sigurim pensional dhe invalidor, e as nuk merret parasysh kohezigjatja e stazhit të mbushur pensional të të siguruarit.

(2) Me kërkesën për kompensim të demit mund të përfshihet shumata e përgjithshme e demit ose shumata e pjesës së demit, e llogaritur për periudhë të caktuar kohore që ka kaluar.

(3) Kur demin përmbahet në obligim të Fondit për shpenzime të perhershme në para, Fondi mund të kërkojë pagesë të kompensimit të demit në shumën e përgjithshme. Kjo shumë llogaritet sipas lartësisë së pensionit të pranuar, kompensimit në para për demtim trupor dhe kompensimit në para për ndihmë dhe kurim sipas kohezigjatjes së mundshme të perdorimit të atyre të drejtave.

Neni 220

Kompensimi i demit, shkaku i Fondit, perkatesisht kthimi i pagesave të kryera të paligjshme dhe të parregullta të pensioneve dhe shpenzimeve tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor, kryhet sipas dispozitave të Ligjit për marrëdhënie obliguese.

XII. DISPOZITA KUNDERVAJTESE

Neni 221

(1) Gjore në shume prej 2 000 deri në 3 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje subjekteve nese nuk parashtrojne fletëparaqitje për sigurim në pajtim me nenin 125 paragrafi (4) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të ketij ligji.

(2) Gjore në shume prej 2 000 deri në 3 000 euro në kundervlere me denare për kundervajtje do t'i shqiptohet detyresit për llogaritje dhe pagese të kontributit, nese:

1) nuk paraqet të dhena për fillimin dhe perfundimin e punes, dhe ndryshimet gjate punes ose ato të dhena i paraqet pas kalimit të afatit të percaktuar nga neni 209 pika 1 e ketij ligji;

2) nuk paraqet të dhena për sigurim, cregjistrim të sigurimit, dhe ndryshimet gjate sigurimit ose i paraqet pas kalimit të afatit të percaktuar nga neni 209 pika 2 e ketij ligji;

3) nuk paraqet të dhena për stazhin e sigurimin, rrogat, kompensimet e rroges, perkatesisht bazat e sigurimit ose i paraqet pas kalimit të afatit të percaktuar nga neni 209 pika 3 e ketij ligji;

4) paraqet të dhena të pasakta për udheheqjen e evidences amë nga neni 211 paragrafi (1) i ketij ligji dhe

5) në afatin nga neni 206 paragrafi (1) i ketij ligji që e ka percaktuar Fondi, nuk kryen permiresim të të dhenave për stazhin e sigurimit, rrogat, kompensimet e rroges, perkatesisht bazat e sigurimit.

(3) Gjore në shume prej 300 deri në 600 euro në kundervlere me denare për kundervajtjen nga paragrafi (2) i ketij neni, do t'i shqiptohet personit pergjegjes tek detyresi për llogaritjen dhe pagesen e kontributit.

Neni 222

Gjore në shume prej 400 deri në 800 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje të siguruarit nga neni 11 paragrafi (1) pikat 7, 8 dhe 9 të ketij ligji, nese:

1) nuk paraqet të dhena për fillimin dhe perfundimin e punes, dhe ndryshimet gjate punes ose i paraqet pas kalimit të afatit të percaktuar nga neni 209 pika 1 e ketij ligji;

2) nuk paraqet të dhena për fillimin dhe nderprerjen e sigurimit, dhe ndryshimet gjate sigurimit ose ato të dhena i paraqet pas kalimit të afatit të percaktuar nga neni 209 pika 2 e ketij ligji dhe

3) nuk paraqet të dhena për stazhin e sigurimin, rrogat, kompensimet e rroges, perkatesisht bazat e sigurimit ose ato të dhena i paraqet pas kalimit të afatit të percaktuar nga neni 209 pika 3 e ketij ligji;

Neni 223

(1) Gjore në shume prej 400 deri në 800 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet personit, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 214 paragrafi (3) i ketij ligji.

(2) Organ kompetent për shqiptimin e sanksionit kundervajtes nga nenet 221, 222, 223 dhe 224 të ketij ligji eshte gjykata kompetente.

Neni 224

Kur doktori specialist që merr pjese në proceduren e percaktimit të invaliditetit, perkatesisht paaftesise për pune, në punen e tij në menyre të pabazuar konstaton ekzistim të invaliditetit ose nuk paraqet dokumentacion mjekesor të pavertete, perkatesisht të gabuar, kjo paraqet shkelje të obligimeve të percaktuara me ligj dhe baze për nderprerjen e marrëdhënies së punes me pushim nga puna.

Neni 225

Personi që ka leshuar dokumentacion mjekesor të gabuar ose të pavertete, në menyre të pabazuar ka konstatuar ekzistim të invaliditetit ose nuk ka paraqitur invaliditet, ose ka dorezuar dokumentacion mjekesor të pavertete, do të pergjigjet për veper penale dhe do të denohet në pajtim me Kodin Penal.

XIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 226

Shfrytezuesve që të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor i kane realizuar para dites së dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji, ato të drejta u sigurohen edhe pas dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji, në vellim dhe lartesi të njejte dhe harmonizohen sipas dispozitave të ketij ligji.

Neni 227

Shfrytezuesve të shumes më të ulet të pensionit dhe shfrytezuesve të pensionit më të larte, të cilet pensionin e kane realizuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të ketij ligji, shuma e percaktuar e pensionit gjate vitit, u harmonizohet me perqindjen me të cilen harmonizohen pensionet tjera.

Neni 228

(1) Pensioni i pleqerise për të siguruarit nga neni 11, me perjashtim të pikes 9 dhe neneve 11 dhe 12 të ketij ligji, që jane perfshire në sigurimin e detyrueshem pensional me financim kapital deri më 1 shtator 2001 dhe që nuk kane zgjedhur të perfshihen në sigurimin e detyrueshem pensional me financim kapital dhe që kane stazh të plotesuar pensional së paku 15 vite, percaktohet nga baza pensionale varesisht nga kohezgjatja e stazhit pensional dhe eshte:

Stazhi pensional	Perqindja	
	mashkull	femer
15 vjet	35	40
15 vjet e 6 muaj	35,9	41,3
16 vjet	36,8	42,6
16 vjet e 6 muaj	37,7	43,9
17 vjet	38,6	45,2
17 vjet e 6 muaj	39,5	46,5
18 vjet	40,4	47,8
18 vjet e 6 muaj	41,3	49,1
19 vjet	42,2	50,4
19 vjet e 6 muaj	43,1	51,7
20 vjet	44,0	53,0
20 vjet e 6 muaj	44,9	53,9
21 vjet	45,8	54,8
21 vjet dhe 6 muaj	46,7	55,7
22 vjet	47,6	56,6
22 vjet e 6 muaj	48,5	57,5
23 vjet	49,4	58,4
23 vjet e 6 muaj	50,3	59,3
24 vjet	51,2	60,2
24 vjet e 6 muaj	52,1	61,1
25 vjet	53,0	62,0
25 vjet e 6 muaj	53,9	62,9
26 vjet	54,8	63,8

26 vjet e 6 muaj	55,7	64,7
27 vjet	56,6	65,6
27 vjet e 6 muaj	57,5	66,5
28 vjet	58,4	67,4
28 vjet e 6 muaj	59,3	68,3
29 vjet	60,2	69,2
29 vjet e 6 muaj	61,1	70,1
30 vjet	62,0	71,0
30 vjet e 6 muaj	62,9	71,9
31 vjet	63,8	72,8
31 vjet dhe 6 muaj	64,7	73,7
32 vjet	65,6	74,6
32 vjet e 6 muaj	66,5	75,5
33 vjet	67,4	76,4
33 vjet e 6 muaj	68,3	77,3
34 vjet	69,2	78,2
34 vjet e 6 muaj	70,1	79,1
35 vjet	71,0	80,0
35 vjet e 6 muaj	71,9	
36 vjet	72,8	
36 vjet e 6 muaj	73,7	
37 vjet	74,6	
37 vjet e 6 muaj	75,5	
38 vjet	76,4	
38 vjet e 6 muaj	77,3	
39 vjet	78,2	
39 vjet e 6 muaj	79,1	
40 vjet	80,0	

(2) Për të siguruarit nga paragrafi (1) i këtij neni për çdo vit të metejme stazhi pensional të plotësuar pas 1 janarit 2013, pensioni perlllogaritet në lartësi prej 1,61%, kurse për stazh pensional më të shkurter se një vit, e së paku gjashte muaj është 0,81% nga baza e pensionit.

(3) Për të siguruarit nga paragrafi (1) i këtij neni, që janë perfshire në shtyllen e pare pensionale deri më 1 shtator 2001 dhe që nuk kane zgjedhur të perfshihen në shtyllen e dyte pensionale dhe që kane stazh pensional të plotësuar më pak se 15 vjet, pensioni sipas pleqerise percaktohet nga baza pensionale në perqindje që për çdo vit stazh pensional të plotësuar deri më 1 shtator 2001 jane 2,33% (mashkull), perkatesisht 2,60% (femer), kurse për stazh pensional më të shkurter se një vit, e së paku gjashte muaj është 1,165% (mashkull), perkatesisht 1,30% (femer) nga baza e pensionit. Për çdo vit të metejme të stazhit pensional të plotësuar pas 1 shtatorit 2001 e deri më 31 dhjetor 2012, pensioni perlllogaritet në lartësi prej 1,80%, (mashkull), perkatesisht 2,05% (femer), kurse për stazh pensional më të shkurter se një vit, e së paku gjashte muaj është 0,90%, (mashkull), perkatesisht 1,025% (femer) nga baza e pensionit.

(4) Për të siguruarit nga paragrafi (3) i këtij neni për çdo vit të metejme stazhi pensional të plotësuar pas 1 janarit 2013, pensioni perlllogaritet në shume prej 1,61% (mashkull), perkatesisht 1,84% (femer), kurse për stazh pensional më të shkurter se një vit, e së paku gjashte muaj është 0,81%, (mashkull), perkatesisht 0,92% (femer) nga baza e pensionit.

Neni 229

(1) Procedurat e filluara para dites së hyrjes në fuqi të këtij ligji do të perfundohen sipas rregullave që kane qene në fuqi në kohen e fillimit të procedures.

(2) Procedura nga paragrafi (1) i ketij neni do të zbatohet edhe për të siguruarit që kane parashtruar kerkese për realizimin e të drejtes së pensionit sipas pleqerise nese nderprerja e marredhenies së punes eshte para hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 230

(1) Për të siguruarit që nuk kane hyre në sigurimin e detyrueshem pensional me financim kapital, pensioni më i larte nuk mund të jete më shume se 80% deri në vitin 2015, kurse pas vitit 2015 jo më shume se perqindjet e percaktuara nga neni 52 paragrafi (1) i ketij ligji nga rroga neto mesatare e realizuar në Republike në vitin e kaluar e rritur për 2,7 here.

(2) Pensioni më i larte i percaktuar nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk ripercaktohet dhe më tutje harmonizohet me perqindjen me të cilen harmonizohen edhe pensionet tjera.

Neni 231

Personat që nuk kane cilesi të të siguruarve sipas ketij ligji, por kete cilesi e kane pasur sipas rregullave të meparshme, si dhe anetaret e familjeve të tyre dhe anetaret e familjeve të shfrytezuesve të të drejtave sipas rregullave të meparshme, mund që të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor t'i realizojne në kushtet e percaktuara me kete ligj.

Neni 232

Pensionet e luftetareve të LNÇ-së, të pjesemarresve në Levizjen nacionalclirimtare në Greqi, të pjesemarresve në Levizjen nacionalclirimtare në pjesen e Maqedonise së Egjeut dhe të anetareve të familjeve të tyre, të realizuara para hyrjes në fuqi të ketij ligji sipas Ligjit për të drejtat themelore të sigurimit pensional dhe invalidor, Ligjit për bartesit e "Perkujtimores së partizaneve 1941" dhe Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, u sigurohen edhe pas dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji në vellim dhe lartesi të percaktuar sipas atyre rregullave, me ç'rast keto pensione mund të paguhen më së shumti deri në shumen e pensionit më të larte të percaktuar me kete ligj.

Neni 233

Pensionet e të siguruarve ushtarake të realizuara para dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor të të siguruarve ushtarake, u sigurohen edhe pas hyrjes në fuqi ketij të ketij ligji në vellim dhe lartesi të percaktuara me ato rregulla, me ç'rast keto pensione mund të paguhen më së shumti deri në shumen e pensionit më të larte të percaktuar me kete ligj.

Neni 234

Mjetet për pagese të pensioneve dhe të ardhurave tjera nga neni 232 i ketij ligji, i siguron Buxheti i Republikes së Maqedonise.

Neni 235

Mjetet për mbulimin e detyrimeve që dalin me pranimin e të drejtave për kushtet më të volitshme në pajtim me nenin 233 të ketij ligji sigurohen nga Buxheti i Republikes së Maqedonise.

Neni 236

Shfrytezuesve të pensionit sipas pleqerise dhe familjar minimal, që të drejten e pensionit e kane realizuar sipas Ligjit për sigurimin sipas pleqerise të bujqve dhe Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, ato të drejta u sigurohen edhe pas dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 237

(1) Pas vdekjes së shfrytezuesit të pensionit minimal sipas pleqerise nga neni 236 i ketij ligji, bashkeshorti i tij mund të fitoje të drejten e pensionit familjar, nese pas vdekjes së shfrytezuesit, bashkeshorti ka mbushur 65 vjet (mashkull), perkatesisht 60 vjet (femer), kurse për luftetar të LNÇ-së deri më 9 shtator 1944 - 60 vjet (mashkull), perkatesisht 55 vjet (femer).

(2) Pensioni familjar nga paragrafi (1) i ketij neni, percaktohet në shume të njejte si edhe pensioni minimal sipas pleqerise.

Neni 238

Mjetet për pagesen e pensioneve nga nenet 236 dhe 237 të ketij ligji, sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonise.

Neni 239

(1) Të siguruarit që kane status të bujqve individuale, për plotesim të kushteve për realizimin e të drejtes për pension sipas pleqerise, në stazh të sigurimit do të llogaritet edhe koha e kaluar në sigurim, sipas Ligjit për sigurim sipas pleqerise të bujqve, nese kontributi për atë sigurim eshte i paguar gjate kohes kur ka qene në fuqi ai ligj.

(2) Nese i siguruari nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk ka stazh të plote të percaktuar të sigurimit pas 1 janarit 1989, për plotesim të kushteve për realizimin e të drejtes për pension sipas pleqerise, do të llogaritet edhe koha e kaluar në sigurim, sipas Ligjit për sigurim sipas pleqerise të bujqve, nese kontributi për atë sigurim eshte i paguar gjate kohes kur ka qene në fuqi ai ligj dhe nese kryhet pagesa e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor për periudhen pas 1 janarit 1989, për më së shumti 5 vite.

Neni 240

Gjate percaktimit të koeficienteve për valorizimin e rrogave për vitin 2009, koeficientet e percaktuar nga neni 33 i ketij ligji shumezohen me faktorin si vijon:

rrogen neto 2008

rrogen bruto 2008

rrogen neto 2009

rrogen bruto 2009

Gjate percaktimit të koeficienteve për valorizim të rrogave për vitin 2010 koeficientet e percaktuar nga neni 33 i ketij ligji shumezohen me faktorin si vijon:

rrogen neto 2009

rrogen bruto 2009

rrogen neto 2010

rrogen bruto 2010

Gjate percaktimit të koeficienteve për valorizim të rrogave për vitin 2011 koeficientet e percaktuar nga neni 33 i ketij ligji shumezohen me faktorin si vijon:

rrogen neto 2010

rrogen bruto 2010

rrogen neto 2011

rrogen bruto 2011

Koeficientet për valorizim të rrogave percaktohen në baze të ndryshimit të rrogave të të gjithë të punesuarve në Republikën e Maqedonise të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikes.

Neni 241

Mungesa e mjeteve në sigurimin e detyrueshem pensional dhe invalidor në baze të solidaritetit të gjenerates, të shkaktuar për shkak të vendosjes së sigurimit të detyrueshem pensional me financim kapital, do të sigurohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonise.

Neni 242

(1) Deri në percaktimin e të drejtes për kompensim të shpenzimeve për vendosje dhe ushqim të femijeve me pengesa në zhvillimin psikofizik, me ligj, femija i të siguruarit, perkatesisht i shfrytezesit të pensionit familjar, me pengesa në zhvillimin psikofizik ka të drejte për kompensim të shpenzimeve për vendosje dhe ushqim gjate aftesimit profesional, perkatesisht aftesimit për pune.

(2) Si femije me pengesa në zhvillimin psikofizik, sipas paragrafit (1) të ketij neni, konsiderohet femija që sipas rregullave të vecanta për kategorizim dhe evidentim të femijeve të tille eshte konstatuar se eshte me pengesa në zhvillimin psikofizik.

(3) Në afatin nga paragrafi (1) i ketij neni, Fondi me akt të pergjithshem më afersisht do ta percaktoje menyren në të cilen femijeve me pengesa në zhvillimin psikofizik u sigurohet kompensim për vendosje dhe ushqim gjate aftesimit profesional, perkatesisht aftesimit për pune.

Neni 243

Aktet nenligjore, miratimi i të cilave eshte parapare me kete ligj do të miratohen në afat prej 30 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi e ketij ligji.

Neni 244

Deri në miratimin e Listes së semundjeve profesionale dhe Listes së demtimeve trupore, semundjet profesionale dhe demtimet trupore, do të percaktohen sipas listave që jane aplikuar me ditën e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 245

(1) Drejtori, zevendesdrejtori dhe anetaret e Keshillit Drejtues të Fondit të emeruar para dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji, vazhdojne ta ushtrojne funksionin deri në emerimin e drejtorit, zevendesdrejtorit dhe anetareve të Keshillit Drejtues në pajtim me kete ligj.

(2) Anetaret e Komisionit revizion të konstatimit, vleresimit dhe mendimit me të cilin percaktohet invaliditet, perkatesisht paaftesi për pune, të percaktuara para dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji, do të vazhdoje t'i kryejne punet në komision deri në caktimin e anetareve të rinj.

(3) Deri në caktimin e organit, perkatesisht institucionit në të cilin do të formohet Komision për kontroll të detyrueshem, kontrolli i detyrueshem do të kryhet nga anetaret e Komisionit për kontroll të detyrueshem.

Neni 246

Statuti, akti për organizim të brendshem dhe akti për sistematizimin e vendeve të punes të Fondit, do të harmonizohen me kete ligj në afat prej 15 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi e ketij ligji.

Neni 247

I siguruari nga Kreu VII - Marrja dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguararve në kushte të vecanta, i cili nga dita e fillimit të anetaresimit në sigurimin e detyrueshem pensional me financim kapital deri në ditën e hyrjes në fuqi të ketij ligji e ka ndryshuar cilesine e të siguruarit, mundet vetem një here me zgjedhje të vet ta revokoje statusin e percaktuar. Kete të drejte i siguruari mund ta kryeje më së voni në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 248

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen Ligji për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 80/93, 3/94, 14/95, 71,96, 32/97, 24/2000, 96/2000, 50/2001, 85/2003, 50/2004, 4/2005, 84/2005, 101/2005, 70/2006, 153/2007, 152/2008, 161/2008, 81/2009, 156/2009, 83/10, 156/10, 24/11, 51/11 dhe 11/12) dhe Ligji për evidencën amë të të siguruarve dhe shfrytëzuesve të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 16/2004, 55/2007, 102/2008 dhe 51/11).

Neni 249

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave të nenit 239 të këtij ligji, të cilat do të zbatohen gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse dispozitat nga neni 19 paragrafi (2) i këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2013.